

**ALPHA BANK ALBANIA SH.A**

**Pasqyrat financiare**  
**për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**  
**(me raportin e audituesve të pavarur)**

---

## Përmbajtja

---

<b>Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse</b>	<b>1</b>
<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>	<b>2</b>
<b>Pasqyra e ndryshimeve në kapital</b>	<b>3</b>
<b>1. Informacion i përgjithshëm</b>	<b>5</b>
<b>2. Bazat e përgatitjes</b>	<b>5</b>
<b>4. Menaxhimi i rrezikut financiar</b>	<b>23</b>
<b>5. Shënime shpjeguese për vlerën e drejtë</b>	<b>41</b>
<b>6. Të ardhurat neto nga interesat</b>	<b>44</b>
<b>7. Të ardhurat neto nga komisionet</b>	<b>44</b>
<b>8. Shpenzime personeli</b>	<b>45</b>
<b>9. Të ardhura minus shpenzime nga transaksionet financiare</b>	<b>45</b>
<b>10. Shpenzime operative</b>	<b>45</b>
<b>11. Tatim fitimi</b>	<b>46</b>
<b>12. Arka dhe Banka Qendrore</b>	<b>47</b>
<b>13. Hua dhe paradhënie institucioneve financiare</b>	<b>48</b>
<b>14. Letra me vlerë të tregtueshme</b>	<b>48</b>
<b>15. Aktivet financiare mbajtur deri ne maturim</b>	<b>49</b>
<b>16. Aktive financiare të vlefshme për shitje</b>	<b>50</b>
<b>17. Hua dhe paradhënie dhënë klientëve</b>	<b>51</b>
<b>18. Aktivet afatgjata materiale</b>	<b>53</b>
<b>19. Aktivet afatgjata jomateriale</b>	<b>54</b>
<b>20. Aktive të tjera dhe aktive afatgjata të mbajtura për shitje</b>	<b>54</b>
<b>21. Detyrime ndaj bankave</b>	<b>55</b>
<b>22. Detyrimet ndaj klienteve</b>	<b>55</b>
<b>23. Borxhi i varur</b>	<b>55</b>
<b>24. Detyrime të tjera</b>	<b>56</b>
<b>25. Kapitali aksionar</b>	<b>56</b>
<b>26. Rezerva ligjore</b>	<b>56</b>
<b>27. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to</b>	<b>57</b>
<b>28. Angazhime dhe detyrime të mundshme</b>	<b>57</b>
<b>29. Transaksionet me palët e lidhura</b>	<b>58</b>
<b>30. Ngjarje pas datës së bilancit</b>	<b>58</b>



**KPMG Albania Sh.p.k**  
"Dëshmorët e Kombit" Blvd  
Twin Towers Buildings  
Building 1, 13th floor  
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524  
+355(4)2274 534  
Telefax +355(4)2235 534  
E-mail al-office@kpmg.com  
Internet www.kpmg.al

## Raporti i Audituesve të Pavarur

Aksionarit të  
Alpha Bank Albania Sh.a

Tiranë, 31 mars 2014

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Alpha Bank Albania Sh.a ("Banka") të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013, pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

### *Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

### *Opinion*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale gjendjen financiare të Bankës më 31 dhjetor 2013, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

### *Çështje të tjera*

Pasqyrat financiare të Bankës më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 janë audituar nga një auditues tjetër që shprehu një opinion pa rezervë mbi ato pasqyra më 28 mars 2013.

Steven Nutley  
Partner

KPMG Albania Sh.p.k.  
"Dëshmoret e Kombit" Blvd.  
Twin Towers Buildings  
Building 1, 13th floor  
Tirana, Albania

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 (Shumat në LEK'000)

	Shënime	2013	2012
Të ardhura nga interesat	6	4,636,665	4,916,197
Shpenzime për interesat	6	(2,638,525)	(2,515,691)
<b>Të ardhura neto nga interesat</b>		<b>1,998,140</b>	<b>2,400,506</b>
Të ardhura nga komisionet	7	236,114	211,466
Shpenzime për komisionet	7	(41,002)	(47,774)
<b>Të ardhura neto nga komisionet</b>		<b>195,112</b>	<b>163,692</b>
Fitimi/humbja nga transaksionet financiare	9	937,251	201,031
Të ardhura të tjera operative		4,215	1,733
		<b>941,466</b>	<b>202,764</b>
<b>Totali i të ardhura operative</b>		<b>3,134,718</b>	<b>2,766,962</b>
Shpenzime personeli	8	(589,153)	(563,262)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	18, 19	(211,124)	(280,513)
Shpenzime të tjera operative	10	(1,131,641)	(1,215,487)
Humbje nga zhvlerësimi i kredive	17	(993,805)	(634,733)
<b>Total shpenzime operative</b>		<b>(2,925,723)</b>	<b>(2,693,995)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>208,995</b>	<b>72,967</b>
Shpenzime tatim fitimi	11	(223,432)	(33,575)
<b>(Humbje)/Fitimi i vitit pas tatimit</b>		<b>(14,437)</b>	<b>39,392</b>
<b>Të ardhura të tjera përmbledhëse:</b>			
<b>Zëra që janë ose mund të klasifikohen në fitim ose humbje</b>			
Rivlerësimi i aktiveve financiare VPS	16	(178,675)	824,242
Kreditim/(shpenzim) tatimi	11	3,451	(46,701)
Rivlerësimi i aktiveve financiare VPS, net		<b>(175,224)</b>	<b>777,541</b>
<b>(Humbje)/të ardhura të tjera përmbledhëse</b>		<b>(175,224)</b>	<b>777,541</b>
<b>Total (humbje)/të ardhura përmbledhëse të vitit</b>		<b>(189,661)</b>	<b>816,933</b>

Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse duhet lexuar bashkë me shënimet nga faqja 5 deri në 58, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Pasqyra e pozicionit financiar


Më 31 dhjetor 2013

(Shumat në LEK'000)

	Shënim	2013	2012
<b>Aktivët</b>			
Arka dhe Banka Qendrore	12	10,992,540	7,458,976
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	13	7,652,965	7,964,663
Letra me vlerë të tregtueshme	14	-	2,174,997
Aktive financiare të vlefshme për shitje ('VPS')	16	20,605,947	8,930,706
Aktive financiare mbajtur deri në maturim ('MDM')	15	9,160,674	15,855,918
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	17	31,860,693	35,114,671
Tatim fitimi i parapaguar		30,589	287,316
Aktivët afatgjata materiale	18	936,253	1,078,304
Aktivët afatgjate jomateriale	19	48,855	80,356
Aktive të tjera	20	237,870	228,924
Aktive afatgjata të mbajtura për shitje	20	289,191	272,484
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>81,815,577</b>	<b>79,447,315</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj bankave	21	124,381	-
Detyrime ndaj klientëve	22	67,435,014	64,780,312
Borxhi i varur	23	2,253,954	2,243,742
Detyrime tatimore të shtyra	11	43,251	87,213
Detyrime të tjera	24	405,897	593,308
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>70,262,497</b>	<b>67,704,575</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	25	10,960,120	10,960,120
Rezerva ligjore	26	817,483	817,483
Rezerva të tjera		1,897	177,120
Humbja e akumuluar		(226,420)	(211,983)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>11,553,080</b>	<b>11,742,740</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar</b>		<b>81,815,577</b>	<b>79,447,315</b>


Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar bashkë me shënimet nga faqja 5 deri në 58, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Komiteti i Kontrollit të Alpha Bank Albania SHA më 31 Mars 2014, dhe janë nënshkruar nga:



Periklis Drougkas

Drejtor i Përgjithshëm



Konstantinos Mouroutsos

Drejtor i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 (Shumat ne LEK'000)

	Shënime	Kapitali aksioner	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Humbje të mbartura	Totali
<b>Gjendja më 1 Janar 2012</b>		<b>9,336,728</b>	<b>817,483</b>	<b>(357,229)</b>	<b>(251,375)</b>	<b>9,545,607</b>
Fitimi i vitit		-	-	-	39,392	<b>39,392</b>
Rivlerësimi i aktiveve financiare VPS, neto		-	-	777,541	-	<b>777,541</b>
<b>Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	<b>777,541</b>	<b>39,392</b>	<b>816,933</b>
Rritje kapitali	25	1,380,200	-	-	-	<b>1,380,200</b>
Rezerva e rivlerësimit të letrave me vlerë	25	243,192	-	(243,192)	-	<b>-</b>
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve të aksionarët</b>		<b>1,623,392</b>	<b>-</b>	<b>(243,192)</b>	<b>-</b>	<b>1,380,200</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2012</b>		<b>10,960,120</b>	<b>817,483</b>	<b>177,120</b>	<b>(211,983)</b>	<b>11,742,740</b>
Humbja e vitit		-	-	-	(14,437)	<b>(14,437)</b>
Rivlerësimi i aktiveve financiare VPS, neto		-	-	(175,224)	-	<b>(175,224)</b>
<b>Totali i humbjeve përmbledhëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(175,224)</b>	<b>(14,437)</b>	<b>(189,661)</b>
Kontributet dhe shpërndarjet të aksionarët		-	-	-	-	<b>-</b>
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve të aksionarët</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2013</b>		<b>10,960,120</b>	<b>817,483</b>	<b>1,897</b>	<b>(226,420)</b>	<b>11,553,080</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar bashkë me shënimet nga faqja 5 deri më 58, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 (Shumat në LEK'000)

	Shënim	2013	2012
Flukset monetare nga aktivitetet operative:			
Fitimi para tatimit		208,995	72,967
<i>Rregullimet për:</i>			
Amortizim dhe zhvlerësim	18,19	211,124	280,513
(Fitim)/Humbje nga shitja e aktiveve afatgjata		(1,433)	-
Aktivitet afatgjata të nxjerra jashtë përdorimi	18	-	50,106
Zhvlerësimi i huave dhe paradhëniet e klientit	17	993,805	634,733
(Fitim)/humbja neto nga vlera e letrave të tregtueshme		(45,117)	1,170
Te ardhurat nga interesat	6	(4,636,665)	(4,916,197)
Shpenzimet nga interesat	6	2,638,525	2,515,691
		(630,766)	(1,361,017)
Ndryshime në:			
Rezervën e detyrueshme		(347,312)	(214,763)
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve		3,383,216	3,196,968
Portofoli tregues		2,174,997	(1,312,691)
Aktive të tjera		105,747	272,195
Detyrime ndaj bankave		124,381	(1)
Detyrime ndaj klientëve		2,701,567	3,504,924
Detyrime të tjera		(224,436)	(232,324)
Interesi i paguar		(2,675,176)	(2,539,285)
Interesi i arkëtuar		3,513,621	4,610,420
Tatim fitimi i paguar		(105,042)	-
<b>Flukset neto nga aktivitetet operative</b>		<b>8,020,797</b>	<b>5,924,426</b>
Flukset monetare nga aktivitetet investuese:			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	18,19	(38,518)	(48,624)
Shitja e aktiveve afatgjata materiale		2,379	1,726
Blerje e letrave me vlerë të investimit		(5,110,104)	(5,601,581)
<b>Flukset neto perdorur nga aktivitetet investuese</b>		<b>(5,146,243)</b>	<b>(5,648,479)</b>
Flukset monetare nga aktivitetet financuese:			
Kapital i paguar	25	-	1,380,200
<b>Flukset monetare neto nga aktivitetet financuese</b>		<b>-</b>	<b>1,380,200</b>
<b>Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to</b>		<b>2,874,554</b>	<b>1,656,147</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente në fillim të vitit		9,249,324	7,593,177
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente në fund të vitit</b>	27	<b>12,123,878</b>	<b>9,249,324</b>

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet lexuar bashkë me shenimet nga faqja 5 deri në 58, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 1. Informacion i përgjithshëm

Alpha Bank A.E. – Dega Tiranë u themelua në vitin 1998 si një degë e Alpha Bank A.E., Athinë (“Zyra Qendrore”), e cila është kompania mëmë e shoqërive të Grupit Alpha Bank. Në 19 dhjetor 2006, Bordi i Drejtorëve të zyrës qendrore, aprovoi një ndryshim në emrin e bankes në Alpha Bank – Albania (“Banka”). Zyrat e regjistruara të Bankës gjenden në adresën “Rruga e Kavajes, Ndërtesa G – Kam, kati i 2-të, Tiranë, Shqipëri”.

Më 29 shkurt 2012 Banka u transformua në filial me anë të vendimit Nr. 14 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë (më tej referuar si “Banka Qendrore”) dhe u licencua më 17 maj 2012 për të kryer transferta, aktivitete kreditimi dhe mbajtje depozitash, si edhe aktivitete të tjera në përputhje me Ligjin për Bankat (Nr. 8365, datë 2 korrik 1998, ndryshuar më 18 dhjetor 2006) dhe Ligjin për Bankën e Shqipërisë (Nr. 8269, datë 23 dhjetor 1997), dhe ndryshoi emrin në Alpha Bank Albania SHA.

Banka ushtron aktivitetin e saj në të gjithë vendin nëpërmjet 42 degëve (2012: 42 degë), me 11 degë në Tiranë (2012: 11 degë).

### 2. Bazat e përgatitjes

#### (a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”).

#### (b) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të asetëve më poshtë të matura me vlerë të drejtë:

- Aktiveve financiare të tregtueshme
- Aktiveve financiare të vlefshme për shitje

#### (c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Bankës, dhe janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt (Lek’000), përveç rasteve kur shprehet ndryshe.

#### (d) Gjykime të rëndësishme të kontabilitetit, vlerësime dhe supozime

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon nga drejtimi i Bankes përdorimin e gjykimeve, vlerësimeve dhe supozimeve, të cilat prekin aplikimin e politikave kontabël dhe aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e raportuara. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga ai i vlerësuar.

Vlerësimet dhe supozimet e perdorura rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel njihen në periudhen në të cilën ato kryhen ose në periudhat e ardhshme që preken nga ky rishikim.

Informacioni mbi gjykimet e pasigurta dhe ato kritike që përdoret gjatë aplikimit të politikave kontabel dhe që kane ndikimin më të rëndësishëm mbi vlerat e njohura në pasqyrat financiare është përshkruar në paragrafet e mëposhtem.

Gjatë procesit të aplikimit të politikave kontabël të Bankës, drejtimi ka ushtruar gjykim dhe vlerësim në përcaktimin e shumave të njohura në pasqyrat financiare. Përdorimet më të rëndësishme të gjykimeve dhe vlerësimeve janë si vijon:

#### i. Parimi i vijimësisë

Banka ka raportuar humbje të mbartura prej 226,420 mijë Lek më 31 dhjetor 2013 (2012: 211,983 mijë Lek). Drejtimi i Bankës ka kryer një vlerësim të aftësisë së Bankës për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe është bindur se Banka ka burime për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu, Drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.



# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

#### (d) Gjykime të rëndësishme të kontabilitetit, vlerësime dhe supozime (vazhdim)

##### ii. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Kur vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të përfitohet nga tregjet aktive, ajo përcaktohet duke përdorur një larmi teknikash vlerësimi të cilat përfshijnë përdorimin e modeleve matematikore. Të dhënat për këto modele rrjedhin nga të dhënat të vëzhgueshme në treg, aty ku është e mundur, por nëse këto të dhëna nuk janë të disponueshme, për të përcaktuar vlerat e drejta përdoret gjykim. Këto gjykime përfshijnë marrjen parasysh të likuiditetit dhe të dhënat të tilla si luhatjet për derivative me afat të gjatë maturimi si edhe normat e skontimit, normat e parapagimeve si edhe supozimet për normën e mosshlyerjes për aktivet e siguruar me letrat me vlerë.

Politika kontabël e Bankës lidhur me vlerësimin me vlerën e drejtë është diskutuar në shënimin 3(e).

Banka e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme që reflekton rëndësinë e input-eve të përdorura gjatë matjeve:

- Niveli 1: Çmimet e kuotuar (të pandryshuara) të një tregu aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në input-e të vëzhgueshme, ose në mënyrë direkte (si p.sh çmimet), ose në mënyrë indirekte (që rrjedh nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: çmime të kuotuar për instrumenta identikë ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen jo aq aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku gjithë input-et kryesore mund të vëzhgohen në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi duke përdorur input-e të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku teknika e vlerësimit përfshin input-e që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe input-et jo të vëzhgueshme kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen mbi bazën e çmimeve të kuotuar për instrumenta të ngjashëm ku kërkohen korrigjime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të reflektuar diferencat midis instrumentave.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontimit të flukseve monetare, krahasimin me instrumenta të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime të vëzhgueshme në treg dhe të bazuar në një kurbë të kthimit aktual, të përshtatshme për afatin e mbetur deri në maturim. Supozimet dhe input-et e përdorura në teknikat e vlerësimit përfshijnë normat pa risk të interesit dhe normat e referencës të interesit, marzhin e kreditit dhe primeve të tjera të përdorura në vlerësimin e normave të skontimit, çmimet e kapitalit dhe obligacioneve, kurset e këmbimit valutor të monedhës, çmimet e kapitalit dhe indeksin e kapitalit të vet dhe luhatjet e pritshme të çmimeve dhe korrelacionet. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijë në përcaktimin e vlerës së drejtë që reflekton çmimin e instrumentit financiar në datën e raportimit, vlerë e cila do të ishte përcaktuar nga pjesëmarrësit e tregut që veprojnë në mënyrë të vullnetshme dhe janë të palidhur me njëri-tjetrin.

Çmimet e vëzhgueshme dhe input-et e modelit janë zakonisht të disponueshme në treg për obligacionet e listuara dhe letrat me vlerë të kapitalit, për derivativet e këmbyeshme në treg dhe derivativet e thjeshta “mbi bankë”, si për shembull kontratat “sëap” të normave të interesit. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe input-eve të modelit zvogëlon nevojën për gjykim dhe vlerësim të drejtimit si dhe zvogëlon pasigurinë në lidhje me përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmëria e çmimeve të tregut të vëzhgueshme dhe input-eve ndryshon në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur të ndryshojë në bazë të ngjarjeve të veçanta dhe kushteve të përgjithshme në tregjet financiare.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare jepet e detajuar në shënimin 4.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

#### (d) Gjykime të rëndësishme të kontabilitetit, vlerësime dhe supozime (vazhdim)

##### iii. Humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhëniet

Banka rishikon në çdo raportim financiar kredite që janë individualisht të rëndësishme për të vlerësuar nëse ka zhvlerësim që duhet regjistruar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Në vecanti kërkohej gjykimi i drejtimit të bankës në vlerësimin e shumës së flukseve monetare të ardhshme, kur përcaktohet humbja nga zhvlerësimi. Këto vlerësime bazohen në hamendësime mbi disa faktore të ndryshëm të cilat mund të ndryshojnë nga rezultatet reale, duke cuar në ndryshime në provizionimin e ardhshëm.

Vlerësimi kolektiv i marrë të dhënat nga portofoli i huave (të tilla si ditë-vonesat, perdorimi i huave, norma e mbulimit të huasë nga kolaterali, etj.), dhe nga gjykimet e perdorura për të patur një përqendrim të rrezikut dhe të dhënave ekonomike (duke përfshirë nivelin e papunesisë, indeksat e cmimeve të pronave të patundshme, riskun dhe kushtet shtetërore dhe performancën e grupeve individuale të ndryshme).

Në qoftë se në një periudhë të mëvonshme pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi, ngjarje të cilat kërkojnë që humbja nga zhvlerësimi të reduktohet ndodhin, ose ka patur një grumbullim të shumave nga huatë dhe paradhëniet që janë pakësuar në vlerë më parë, shumat e rikuperueshme njihen në të ardhura përmblendhëse si humbje nga zhvlerësimi dhe dispozitat për të mbuluar rrezikun e kredisë. Humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhëniet janë shpalosur në mënyrë më të detajuar në shënimin 17.

##### iv. Zhvlerësimi i investimeve në Aktive financiare të vlefshme për shitje

Banka shqyrton letrat e saj të investimit të klasifikuara si investime në aktive financiare të vlefshme për shitje në çdo datë të pasqyrave financiare për të vlerësuar nëse ato janë zhvlerësuar. Kjo kërkon gjykim të ngjashëm si ai i përdorur për vlerësimin individual të huave dhe paradhëniet.

Banka përcakton se letrat me vlerë të vlefshme për shitje zhvlerësohen kur ka patur një rënie të rëndësishme ose të zgjatur në vlerën e drejtë nën koston e tyre. Përcaktimi i cka është "i rëndësishëm" apo "i zgjatur" kërkon gjykim. Në përgjithësi, Banka konsideron "të rëndësishme" një rënie mbi 20% krahasuar me koston e blerjes së instrumentit. "E zgjatur" është një rënie në vlerën e drejtë nën koston e amortizuar të letres me vlerë, për një periudhë të vazhdueshme që tejkalon një vit. Në marrjen e këtij vendimi, Banka vlerëson, përveç faktorëve të tjerë, lëvizjet historike në çmimin e aksionit dhe kohëzgjatjen, si dhe masën në të cilën vlera e drejtë e një investimi është më e ulët se kostoja e tij. Për më tepër, zhvlerësimi mund të jetë i përshtatshëm, kur ka prova të përkeqësimit të shëndetit financiar të të investuarit, industrisë dhe performancës së sektorit, ndryshime në teknologji, dhe në flukse monetare operacionale dhe financiare.

##### v. Aktivet tatimore të shtyra

Aktivitetet tatimore të shtyra njihen në lidhje me humbjet tatimore deri në masën që është e mundshme që fitimi i tatueshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit humbjet mund të përdoren ose diferencat e përkohshme mund të anulohen. Gjykimet e bëra në vlerësimin e aktiveve tatimore të shtyra dhe detyrimeve janë të paraqitura në shënimin 11.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

#### (a) Ndryshime në politikat kontabël dhe shënime shpjeguese

Përvec ndryshimeve të mëposhtme, politikat kontabël të renditura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në këto pasqyra financiare nga Banka.

Banka ka miratuar standardet e reja të mëposhtme si dhe ndryshime të standardeve, duke përfshirë çdo ndryshim pasues të standardeve të tjera, me një datë zbatimi fillestar më 1 Janar 2013.

- SNRF 13 Matja e vlerës së drejtë
- Prezantimi i të ardhurave të tjera përmbledhëse (Amendim i SNK 1).

Natyra dhe efekti i këtyre ndryshimeve është shpjeguar si më poshtë.

##### (i) Matja e vlerës së drejtë

Në përputhje me dispozitat kalimtare të SNRF 13, Banka ka aplikuar përkufizimin e ri të vlerës së drejtë, siç është përcaktuar në shënimin 3 (e), në mënyrë prospektive. Ky ndryshim nuk ka pasur ndikim të rëndësishëm në matjen e aktiveve dhe detyrimeve të Bankës, por Banka ka përfshirë shënime shpjeguese të reja në pasqyrat financiare, të cilat kërkojnë nga SNRF 13. Këto kërkesa për shënime shpjeguese nuk përfshijnë informacionin krahasues. Megjithatë, këto shënime shpjeguese janë dhënë nga Banka për informacionin krahasues deri në masën e kërkuar nga standardet e tjera në fuqi përpara datës efektive të SNRF 13.

##### (ii) Prezantimi i të ardhurave të tjera përmbledhëse (ATP)

Si rezultat i ndryshimit të SNK 1, Banka ka ndryshuar prezantimin e zerave ATP në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ATP për të evidentuar zerat që do të riklasifikohen në fitim ose humbje vec nga zerat e tjerë që nuk do të riklasifikohen. Informacioni krahasues është riprezantuar në të njëjtën mënyrë. Të gjithë ATP të Bankës janë ose mund të riklasifikohen në fitim ose humbje.

#### (b) Transaksione në monedhë të huaj

Gjatë hartimit të pasqyrave financiare, transaksionet në monedha të ndryshme nga monedha funksionale e Bankës, janë njohur duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale të veprimtarisë me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Në çdo datë raportimi, aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fund-vitit. Aktivet jomonetare dhe detyrimet maten në kosto historike të monedhave të huaja dhe këmben me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

#### (c) Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja vijuese

##### (i) Data e njohjes

Të gjithë aktivet dhe detyrimet financiare janë njohur fillimisht në datën kur Banka bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

##### (ii) Njohja fillestare e instrumentave financiarë

Banka fillimisht njeh huatë dhe paradhënie, depozitat, letrat me vlerë të borxhit të emetuar dhe detyrimet e varura në datën kur ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit kur Banka angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare (duke përfshirë dhe aktivet dhe detyrimet e njohura me vlerën e drejtë në pasqyrën e të ardhurave) njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit të cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen së tij ose emetimin e aktiveve apo detyrimeve financiare (për një zë i cili nuk matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) i shtohen ose zbriten vlerës së drejtë të aktiveve apo detyrimeve financiare, sipas rastit, në njohjen fillestare. Kostot e transaksionit që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes së aktiveve apo detyrimeve financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (c) Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja vijuese (vazhdim)

##### (iii) Klasifikimi i aktiveve financiare

Aktivët financiarë klasifikohen në kategoritë e specifikuara më poshtë:

- Hua dhe llogari të arkëtueshme
- Letra me vlerë të mbajtura në maturim
- Aktive financiare të vlefshme për shitje
- Aktive financiare të njohura me vlerën e drejtë në pasqyrën e të ardhurave

Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i aktiveve financiare dhe përcaktohet gjatë njohjes fillestare. Të gjitha blerjet në mënyrë të rregullt ose shitjet e aktiveve financiare njihen dhe çregjistrohen mbi bazën e datës së tregtimit. Blerjet ose shitjet e rregullta janë blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brenda afateve kohore të përcaktuara në rregulloret ose konventat në treg.

##### (iv) Klasifikimi i detyrimeve financiare dhe kapitalit

###### Klasifikimi si borxh ose kapital

Instrumentat e borxhit dhe kapitalit të emetuar nga Banka janë klasifikuar si detyrime financiare ose si kapital i vet në përputhje me thelbin e marrëveshjeve kontraktuale dhe përkufizimeve të detyrimit financiar dhe instrumentave të kapitalit.

###### Instrumentat e kapitalit

Një instrument kapitali është çdo kontratë që evidenton një të drejtë të mbetur mbi aktivet e Bankës pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj. Instrumentat e kapitalit neto të emetuara nga Banka janë të njohura për shumën e arkëtuar, neto nga kostot direkte të emetimit.

##### (v) Hua dhe paradhënie klientëve dhe bankave

Hua dhe paradhënie për klientët dhe për bankat përfshijnë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv, dhe që Banka nuk ka ndërmend t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt, përveç:

- Atyre që Banka ka për qëllim t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt dhe atyre që Banka gjatë njohjes fillestare i përcakton si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;
- Atyre që Banka, gjatë njohjes fillestare, i përcakton si të vlefshme për shitje.

Kur Banka është qiradhënëse në një marrëveshje qiraje që transferon të qiramarrësit të gjitha rreziqet dhe shpërblimet që lidhen me pronësinë e një aktivi, marrëveshja paraqitet brenda huave dhe paradhënieve. Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në një marrëveshje për të rishitur aktivin (ose një pasuri tërësisht e ngjashme) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme ("repo e anasjelltë ose huamarrje letrash me vlerë"), marrëveshja është kontabilizuar si marrëveshje e anasjelltë riblerjeje (letra me vlerë kolateralizuar) dhe aktivet e lidhura me to nuk njihen në pasqyrat financiare të Bankës.

##### (vi) Letrat me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimit kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre, ose si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, ose të vlefshme për shitje.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (c) Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja vijuese (vazhdim)

##### (vi) Letrat me vlerë të investimit (vazhdim)

##### (1) Instrumenta financiarë të mbajtur deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet fiks të cilat Banka ka qëllimin dhe mundësinë t'i mbajë deri në maturim dhe të cilat nuk janë dizenuar me vlerë të drejtë në fitim ose humbje ose të vlefshme për shitje.

Shitja ose riklasifikimi i një shume të konsiderueshme të instrumentave financiarë të mbajtura deri në maturim do të sillte riklasifikimin e tyre total në të vlefshme për shitje dhe do të ndalonte Bankën që të klasifikonte instrumentat financiarë në të mbajtura deri në maturim për periudhen korrente dhe për dy vitet e ardhshme financiare. Megjithatë, shitja dhe riklasifikimi në një nga situatat e mëposhtme nuk do të ndikonte riklasifikimin:

- shitja dhe riklasifikimi që janë aq pranë maturimit sa që normat e interesit të tregut nuk do të kenë një ndikim të rëndësishëm në vlerën e drejtë të aktivit financiar;
- shitja ose riklasifikimi pasi Banka ka mbledhur pjesën më të madhe të principalit të aktivit, ose
- shitja ose riklasifikimi që vjen si pasojë e ngjarjeve jo të përsëritshme dhe të izoluara përtej kontrollit të bankës, të cilat nuk do të kishte qenë e mundur të parapriheshin.

##### (2) Instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje

Investimet e vlefshme për shitje janë investime jo-derivative që nuk dizenuohen si një kategori tjetër e aktiveve financiare. Investimet e kapitalit të pakuotuar, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, mbarten me kosto. Të gjitha investimet e vlefshme për shitje mbarten me vlerë të drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit në investimet e borxhit të vlefshme për shitje, njihen direkt në humbje ose fitim. Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë njihen në të ardhurat e tjera përmbledhëse deri kur investimi të jetë shitur ose zhvlerësuar dhe fitimi ose humbja e akumuluar të njihet në fitim ose humbje.

##### (3) Instrumentat financiare me vlerën e drejtë përmes fitim-humbjes

Instrumente financiare me vlerën e drejtë përmes fitim-humbjes janë ato instrumente që Banka gjatë njohjes fillestare vendos t'i mase me vlerën e drejtë përmes fitim-humbjes. Instrumentet financiare të tregtueshme njihen fillimisht dhe në vazhdimësi me vlerën e tyre të drejtë, ndërsa kostot e lidhura me këto transaksione shkojnë direkt në pasqyrën e të ardhurave. Të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve aktive njihen si pjesë e të ardhurave prej interesave në pasqyrën e të ardhurave. Aktivitetet dhe detyrimet financiare të tregtueshme nuk riklasifikohen në vijim të regjistrimit fillestar, në dallim të aktiveve jo-derivative të tregtueshme, përveç atyre që maten fillimisht me vlerë të drejtë nëpërmjet humbjeve dhe fitimit të periudhës, që mund të riklasifikohen prej kësaj kategorie vetëm në rast se ato nuk mbahen më për tu shitur apo për tu riblertë në një periudhë afat-shkurter dhe nëse kriteret e mëposhtme përmbushen:

- Nëse aktivi financiar do përmbushë perkufizimin e kredive dhe të arkëtueshmeve, atëherë mund të riklasifikohet nëse Banka ka qëllimin dhe mundësinë për të mbajtur aktivet financiare në të ardhmen e afert ose deri në maturim.
- Nëse aktivi financiar nuk do përmbushë perkufizimin e kredive dhe të arkëtueshmeve, atëherë mund të riklasifikohet prej kategorise së të tregtueshmeve vetëm në "raste të jashtëzakonshme."

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (c) Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja vijuese (vazhdim)

##### (vii) *Borxhi i emetuar dhe fonde të tjera të marra borxh*

Instrumentat financiarë të emetuara nga Banka, që nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, janë klasifikuar si "borxhi i varur", ku substanca e marrëveshjes kontraktuale rezulton në atë që Banka ka një detyrim për t'i shlyer mbajtësit, nëpërmjet mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare, ose të përbushë detyrimin nëpërmjet një mënyre tjetër përveçse duke këmbyer një shumë të caktuar parash ose aktive të tjera financiare për një numër fiks aksionesh në kapitalin e vet.

Pas matjes fillestare, borxhi i emetuar dhe huamarrjet e tjera maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje apo prim gjatë emetimit dhe kosto që janë pjesë përbërëse e Normës Efektive të Interesit (NEI).

Pas njohjes fillestare, borxhi i emetuar dhe huamarrje të tjera maten me kosto të amortizuar duke përdorur NEI. Pjesa e fondeve neto prej instrumentit i alokohet komponentit të detyrimit në datën e lëshimit të tij bazuar në vlerën e drejte (e cila është përgjithësisht e bazuar në cmimet e kuotuar të tregut për instrumente të njëjta detyrimi). Komponenti i kapitalit përfaqëson vlerën e mbetur pas zbritjes së vlerës së përcaktuar për komponentin e detyrimit nga vlera e drejtë për instrumentin në tërësi. Vlera e cfaredo karakteristike derivativi (si psh opsjon blerjeje) që bën pjesë në një instrument financiar të përbërë, përveç komponentit të kapitalit, përfshihet në komponentin e detyrimit.

Një analizë e borxhit të emetuar të Bankës është paraqitur në Shënimin 23.

#### (d) *Mosnjohja e aktiveve dhe detyrimeve financiare*

##### (i) *Aktivitet financiar*

Banka nuk e njeh më një aktiv financiar (e çregjistron) nëse të drejtat kontraktuale për përfitimin e parave nga aktivi janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktivi financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen të njëjtësi tjetër të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar.

Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që krijohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Banka kryen transaksione nëpërmjet të cilëve transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha ose një pjesë të rreziqeve ose shpërblimeve të aktiveve të transferuara. Në rast se Banka mbart të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve, ndërkohë që mbahen të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme, përfshijnë për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e marrëveshjeve të riblerjes.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi 'swap' për aktivet e transferuara, transaksioni kontabilizohet si një transaksion financues i sigurt i njëjtë me riblerjen e transaksionit.

Për transaksionet ku Banka as nuk mban dhe as nuk transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme që rrjedhin nga pronësia mbi aktivin financiar, ajo nuk e njeh (çregjistron) aktivin në rast se nuk ka kontroll mbi të. Të drejtat dhe detyrimet që mbahen gjatë transferimit njihen më vete si aktive dhe detyrime, sipas rastit. Në ato transferime ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin për aq kohë sa ky aktiv rezultojë i përfshirë, gjë e cila përcaktohet nga niveli i ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

Në transaksione të caktuara Banka mban të drejtat e shërbimit ndaj një aktivi financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktivi i transferuar çregjistrohet tërësisht nëse plotëson kriteret e mosnjohjes.

##### (ii) *Detyrimet financiare*

Banka çregjistron detyrimet financiare kur, dhe vetëm kur, detyrimet e Bankës janë shkarkuar, anuluar ose kanë skaduar. Diferenca midis vlerës kontabël neto të detyrimit financiar të çregjistruar dhe shumës së paguar dhe të pagueshme njihet në fitim ose humbje.

Një aktiv ose detyrim njihet për të drejtat e shërbimit, në qoftë se tarifa e shërbimit është më e lartë se shpenzimet e shërbimit (aktiv) ose është më pak se e përshtatshme për të kryer shërbimin (detyrim).

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (e) Përcaktimi i vlerës së drejtë

##### *Politika e zbatueshme pas 1 Janar-it 2013*

‘Vlera e drejte’ është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose një pasiv të transferohet, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në treg në datën e matjes, në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun me të favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejte e një detyrimi pasqyron rrezikun e mosekzekutimit të tij.

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejte të një instrumenti duke përdorur çmim të kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet aktiv në qoftë se transaksionet në lidhje me aktivin apo detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe volum të mjaftueshme për të siguruar informacion të çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi të cilat maksimizojnë përdorimin të inputeve perkatese të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të kishin parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejte të një instrumenti financiar në njohjen fillestare të tij është zakonisht çmimi i transaksionit - dmth vlera e drejte e konsideratës së dhënë ose të marre. Nëse Banka përcakton se vlera e drejte në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejte nuk është evidentuar as me një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim identik e as nuk është e bazuar në një teknike vlerësimi e cila përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vrojtueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejte, rregulluar për të shtyrë në kohë diferencën midis vlerës së drejte në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Me pas, kjo diferencë është njohur në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit, por jo me vone të vlerësimit që mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet.

Në qoftë se një aktiv ose pasiv i matur me vlerën e drejte ka një çmim të ofruar dhe një çmim të kërkuar, atëherë Banka mat aktivet dhe pozicionet e gjata në çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra në çmim të kërkuar.

Vlera e drejte e një llogarie kursimi nuk është me pak se shuma e pagueshme sipas kërkesës, skontuar nga data e parë kur mund të kërkohej pagimi i shumës.

Banka njeh transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejte deri në fund të periudhës raportuese gjatë të cilës ky ndryshim ka ndodhur.

##### *Politika e zbatueshme para 1 Janar-it 2013*

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbëhet ose një detyrim të shlyhet midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën, të mirinformuara, që kryejnë një transaksion në mënyrë të vullnetshme në datën e matjes.

Kur është e mundur, Banka e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar të një tregu aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse çmimet e kuotuar janë lehtësisht dhe rregullisht të disponueshme dhe paraqesin transaksione të tregut aktual që kryhen në mënyrë të rregullt dhe në kushte të barabarta. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, Banka kryen matjen me vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të mirinformuara të palidhura me njëra-tjetrën (nëse është e disponueshme), lidhur me vlerën e drejtë aktuale të instrumentave të tjerë që janë kryesisht të njëjtë, flukset monetare të skontuara dhe modelet e vlerësimit të opsioneve. Teknika e zgjedhur e vlerësimit bazohet maksimalisht të të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në llogaritjet specifike të Bankës, bashkon të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg konsiderojnë në vendosjen e çmimit dhe është në përputhje me metodologjitë ekonomike të pranueshme për vendosjen e çmimit për instrumentat financiarë. Të dhënat për teknikat e vlerësimit paraqesin pritshmërinë e tregut dhe matjet e faktorëve të rreziqeve të trashëguara në instrumentat financiarë.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (e) Përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

Banka kalibron metodat e vlerësimit dhe i teston ato për vlefshmëri duke përdorur çmime të vëzhguara në transaksionet aktuale të tregut në instrumenta të njëjtë ose në të dhëna të tjera të vëzhgueshme në treg. Evidence më e mirë për vlerën e drejtë të një instrumenti financiar në matjen fillestare është çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e dhënë ose e marrë, vetëm nëse vlera e drejtë e atij instrumenti është evidentuar nga krahasimi me transaksione aktuale të tregut për instrumenta të njëjtë (p.sh., pa modifikime ose ripaketim) ose e bazuar në metodat e vlerësimit në të cilat variablat përfshijnë vetëm të dhëna të vëzhgueshme në tregje. Kur çmimet e transaksioneve paraqesin evidencën më të mirë të vlerës së drejtë në njohjen fillestare, instrumenti financiar matet fillimisht me çmimin e transaksionit dhe çdo diferencë midis këtij çmimi dhe vlerës fillestare të përfutur nga një model vlerësimi është njohur më pas në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit por jo më vonë se vlerësimi të mbështetet tërësisht nga të dhëna të vëzhgueshme në treg ose transaksioni të mbyllet.

Aktivet dhe pozicionimet afatgjata maten me çmimin e ofruar, detyrimet dhe pozicionimet afatshkurtra maten me çmimin e kërkuar. Kur Banka ka një pozicionim me rreziqe që kompensojnë njëri tjetrin, çmime “mid-market” janë përdorur për të matur pozicionin e rreziqeve të kompensuar dhe një çmim i kërkuar ose ofertë rregullimi është aplikuar vetëm tek pozicionet e hapura neto. Vlera e drejtë reflekton riskun e kreditimit të instrumentave dhe përfshin rregullime të cilat marrin parasysh riskun e kreditimit të Bankës dhe të palës tjetër kur është e përshtatshme. Llogaritjet e vlerës së drejtë të përfutura nga modelet rregullohen për faktorë të tjerë si rreziku i likuiditetit ose pasiguritë e modeleve, në atë masë që Banka beson që një palë e tretë pjesëmarrëse në treg do i merrte ato në konsideratë për vendosjen e çmimit të një transaksioni.

#### (f) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Në fund të periudhës së raportimit financiar, Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të ndryshëm nga mjetet monetare dhe ekuivalentët me to, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare konsiderohen të zhvlerësuara kur ka evidence që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme të pasasë së aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Banka konsideron mundësinë e zhvlerësimit në nivel individual dhe kolektiv. Të gjithë aktivet financiare individualisht të rëndësishme vlerësohen për zhvlerësim specifik. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen duke grupuar bashkë aktivet financiare (të mbartura me kosto të amortizuara) me karakteristika të njëjta risku.

Evidencë objektive që aktivet financiare (duke përfshirë letrat me vlerë të kapitalit neto) të zhvlerësuara mund të përfshijnë mospagimin ose shkeljet nga huamarrësi, ristrukturimin e kredisë ose paradhëniet nga Banka me kusht që Banka nuk do të konsiderojë të dhënat që një huamarrës ose emetues do të falimentojnë, zhdukjen e një tregu aktiv për instrumentat financiarë, ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme që lidhen me një grup aktivesh të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesve në grup, ose kushte ekonomike që lidhen me dështimin në grup.

Për trajtimin e zhvlerësimit në grup Banka përdor modelimin statistikor të trendeve historike të probabilitetit të mospagimit, kohës së rikuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Probabiliteti i mospagimit, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rikuperimit krahasohen me rezultatet aktuale për të siguruar që ato të mbeten të duhurat.

#### (i) Aktivet financiare me kosto të amortizuara

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me koston e amortizuar maten si diferencë midis vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme skontuar me normën fillestare efektive të interesit të aktiveve. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provizionit kundrejt huave dhe paradhënies. Interesi mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdon të njihet përmes rikthimit të zbritjes. Kur një ngjarje e mëvonshme bën që shumat e humbjes nga zhvlerësimi të ulet, humbja nga zhvlerësimi kthehet (njihet) nëpërmjet fitimit ose humbjes.



# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (f) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

##### (ii) Instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje

Për instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje, Banka vlerëson në çdo datë të pasqyrave financiare nëse ka evidencë objektive që një investim është zhvlerësuar.

Humbjet nga zhvlerësimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje njihen duke transferuar përmes një riklasifikimi, humbjen kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse, në fitim ose humbe. Humbja kumulative që është riklasifikuar nga të ardhura të tjera, në fitim ose humbje, është diferenca midis kostos së blerjes, neto nga çdo shlyerje principali dhe amortizimi, dhe vlerës së drejtë aktuale, minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi e njohur më parë në fitim ose humbje. Ndryshimet në provizionet për zhvlerësim që i atribuohen vlerës në kohë janë pasqyruar si një komponent i të ardhurave nga interesi.

Nëse në një periudhë të mëvonshme vlera e drejtë e një letre me vlerë të vlefshme për shitje që është zhvlerësuar rritet, dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur në fitim ose humbje, humbja nga zhvlerësimi kthehet (rimerrret), dhe shuma e kthimit njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, çdo rritje e mëvonshme në vlerën e drejtë të një letre me vlerë të zhvlerësuar të kapitalit njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse.

##### (iii) Kreditë e rinegociuara

Kur është e mundur, Banka kërkon të ristrukturojë kreditë në vend që të marrë në zotërim kolaterale. Kjo mund të përfshijë shtrirjen e afatit të pagesave dhe rënien dakord për kushte të reja të kredisë. Drejtimi vazhdimisht rishikon kreditë e rinegociuara për t'u siguruar që të gjitha kriteret janë përmbushur dhe se pagesat e ardhshme ka të ngjarë të ndodhin. Kreditë vazhdojnë të jenë subjekt i një vlerësimi individual apo kolektiv nga zhvlerësimi, i llogaritur duke përdorur normën fillestare efektive të interesit të kredisë.

#### (g) Kompensimi i instrumentave financiarë

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë, kur Banka ka të drejtën ligjore për të kompensuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të Bankës.

#### (h) Matja me kosto të amortizuar e instrumentave financiarë

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

#### (i) Qiratë

##### i. Qiratë operative

Qiratë që nuk transferojnë te Banka në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e sendeve me qira janë qira operationale. Pagesat e qirasë operationale njihen si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Qiratë e pagueshme njihen si një shpenzim në periudhën në të cilën ato ndodhin. Pagesat e bëra për qirate operative njihen në pasqyrën e të ardhurave bazur në metodën lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

##### ii. Qiratë financiare

Për qirate financiare, aktivi i marre me qira njihet si aktiv afatgjatë material dhe detyrimi perkates njihet në detyrime të tjera. Pagesat minimale të kryera për qirane financiare ndahen mes shpenzimeve financiare dhe zvogelimit të detyrimit të mbetur. Shpenzimet financiare shpërndahen në çdo periudhë gjatë kohëzgjatjes së qirasë, duke nxjerrë një normë konstante interesi mbi gjëndjen e mbetur të detyrimit.

Pagesat e kushtezuara të qirave njihen duke rishikuar pagesat minimale të qirase për kohën e mbetur të qirase në momentin kur sistemimet për qirane janë konfirmuar.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (j) Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat njihen në atë masë që është e mundur që përfitimet ekonomike do të rrjedhin në Bankë dhe të ardhurat mund të maten me besueshmëri. Kriteret e mëposhtme specifike të njohjes gjithashtu duhet të plotësohen para se të ardhurat njihen.

##### (i) Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së mjetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të mjetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve financiare.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha shumat e paguara ose të marra në avancë, kostot e transaksionit, zbritjet dhe primet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin apo nxjerrjen jashtë përdorimi të një mjeti apo detyrimi financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat të paraqitura si fitim ose humbje përfshin interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare me kosto të amortizuar me normë interesi efektive.

Vlera kontabel e aktiveve apo detyrimeve financiare rregullohet nëse Banka rishikon vlerësimet e pagesave apo arkëtimeve. Vlera kontabel e rregulluar llogaritet bazuar në vlerën fillestare të Normës Efektive të Interesit (NEI) dhe ndryshimi në vlerën kontabël regjistruhet si "Të ardhura të tjera operative".

Në momentin që vlera e regjistruar e aktivitetit financiar ose e një grupi të ngjashëm aktivesh financiare zvogëlohet si pasoje e humbjes nga zhvlerësimi, të ardhurat nga interesi vazhdojnë të njihen duke përdorur normën e interesit të përdorur për të skontuar të hyrat e ardhshme për qëllimet e matjes së humbjes nga zhvlerësimi.

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshijnë:

- Interesin mbi aktivet dhe detyrimet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar, të llogaritura mbi bazën e normës efektive të interesit
- Interesin mbi të gjitha aktivet dhe detyrimet e tregtueshme,

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të të gjitha aktiveve dhe detyrimeve të tregtueshme vijnë si rrjedhojë e aktivitetit tregtar të Bankes dhe prezantohen si të ardhura ose shpenzime neto nga interesi.

##### (ii) Të ardhura dhe shpenzime për komisione dhe tarifa

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifën dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit në një mjet ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv. Banka fiton të ardhura prej komisioneve dhe tarifave nga një shumëllojshmëri e gjere shërbimesh që i ofron klienteve të saj.

Të ardhurat prej tarifave mund të ndahen në dy kategorite e mëposhtme:

##### *Të ardhura nga tarifën e shërbimeve që ofrohen për një periudhë të caktuar*

Tarifat e fituara për ofrimin e një shërbimi gjatë një periudhe të caktuar kohore akumulohen gjatë kësaj periudhe. Këto tarifa përfshijnë të ardhura prej komisioneve dhe manaxhimit të aktiveve, tarifë për kujdestarine, manaxhimin dhe keshillimin.

Tarifa e angazhimit për kredite që ka të ngjarë të disbursohen dhe tarifa të tjera të lidhura me to shtyhen (bashkë me kosto të tjera të lidhura) dhe njihen si sistemime të normës efektive të interesit të këtyre kredive. Kur nuk ka të ngjarë që kredia të disbursohet, tarifa e angazhimit për kredine njihet përgjatë kohës së angazhimit sipas metodës lineare.

##### *Të ardhura nga tarifën e shërbimeve të transaksioneve*

Tarifat që rrjedhin nga negociimi ose pjesëmarrja në negociatat me palët e treta për një transaksion, si për shembull tarifa shërbimi, komisione mbi shitjet, tarifën e vendosjes, përgatitjen e blerjes së letrave të investimit, njihen në perfundim të transaksionit me të cilin lidhen. Tarifat ose komponentet e tarifave që lidhen me një rezultat të caktuar njihen pas përmbushjes së kriterëve perkatëse. Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve lidhen kryesisht me tarifën e shërbimeve dhe transaksioneve, të cilat shpenzohen gjatë kohës që përçohet shërbimi.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (k) Mjete monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, shuma të pakushtëzuara me Bankën Qendrore dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël, të cilat janë subjekt i rreziqeve të parëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Banka në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Aktivet monetare dhe ekuivalentet me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

#### (l) Letra me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimeve fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe më pas mbarten në varësi të klasifikimit të tyre, si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, ose të vlefshme për shitje.

#### (m) Aktivet afatgjata jomateriale

Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me kosto fillestare duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij mjeti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimit njihet në fitim ose humbje sipas bazës lineare mbi jetën e dobishme të programeve, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme e cmuar për programin është kater vjet. Metodatat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit, dhe sistemohen nëse është e nevojshme.

#### (n) Aktivet afatgjata materiale

##### (i) Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale maten me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivit. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivit në punë për qëllimin e përcaktuar dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes dhe ristrukturimin në vendin në të cilin ato ndodhen. Kur pjesët e një zëri të ndërtesës dhe pajisjeve kanë jetë përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndarë (komponentët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimi ose humbja prej shitjes së një zeri të aktiveve afatgjata material përcaktohet duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën e mbartur të atij aktivit, dhe njihet në vlerë neto si “te ardhura të tjera” në pasqyrën e të ardhurave.

##### (ii) Kostot vijuese

Kostoja e pjesëve të zëvendësuara të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve njihet me vlerën e mbartur nëse është e mundshme që në të ardhmen Banka do të ketë përfitime ekonomike nga këto pjesë dhe kostot e tyre mund të njihen në mënyrë të besueshme. Vlera e mbartur e pjesëve të zëvendësuara më pas c’regjistrohet. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në momentin kur lindin.

##### (iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura dhe shpenzimeve me anën e metodës lineare mbi jetën e dobishme të vlerësuar të çdo zeri të aktivit.

Jeta e dobishme e cmuar për periudhën korrente dhe ato krahasuese është si më poshtë.

- Mobilje dhe pajisje zyre 5 vjet
- Automjete 5 vjet
- Pajisje elektronike 4 vjet
- Përmirësimet e ambienteve të marra me qira më e vogla nga jeta e dobishme dhe afati i qirasë

Metodat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit, dhe sistemohen nëse është e nevojshme.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (o) Aktivet afatgjata të mbajtura për shitje

Aktivitet afatgjata ose grupet e aktiveve të mbajtura për shitje, së bashku me detyrimet e lidhura me to që priten të rikuperohen nëpërmjet shitjes, klasifikohen si aktive afatgjata të vlefshme për shitje.

Klasifikimi i mësipërm përdoret nëse aktivi është në dispozicion për shitje të menjëhershme në gjëndjen e tij aktuale dhe shitja është e mundshme. Shitja konsiderohet e mundshme kur ajo vendoset nga Menaxhmenti i cili ka nisur një program aktiv për të gjetur një blerës dhe shitja pritët të përfundojë Brenda vitit. Aktivitet afatgjata të cilat janë blerë ekskluzivisht me qëllimin për tu shitur më vonë, klasifikohen si të vlefshme për shitje në datën e blerjes kur përmbushet kërkesa 1 vjecare dhe është shumë e mundshme që kriteret e tjera të përmbushen brenda një periudhe të shkurtër nga data e blerjes (zakonisht brenda 3 muajsh).

Aktivitet afatgjata të vlefshme për shitje kryesisht përbëhen nga aktivitet e marra me forcë për huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve.

Përpara se këto aktive të klasifikohen si të vlefshme për shitje, ato rivlerësohen në përputhje me standardet përkatëse kontabël.

Aktivitet e vlefshme për shitje njihen fillimisht dhe rivlerësohen me vlerën me të vogël mes asaj kontabël neto dhe vlerës së drejtë minus koston për tu shitur. Cdo humbje që vjen si pasojë e këtij vlerësimi njihet në fitim ose humbje dhe mund të kthehet (rimerrret) në të ardhmen. Aktivitet në këtë kategori nuk amortizohen.

Fitimi ose humbja nga shitja e këtyre aktiveve njihet në fitim ose humbje.

#### (p) Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Vlera kontabël e aktiveve jofinanciare të Bankës, përveç aktiveve për tatime të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitet.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e aktivitet e tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e aktiveve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivitet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivitet ose e njësise gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të aktiveve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitet.

Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim, dhe ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitet nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

Për cdo aktiv bëhet një vlerësim në fund të cdo periudhe raportuese nëse ka tregues që ka humbje nga zhvlerësimi të regjistruara në periudhat paraardhëse të cilat mund të mos ekzistojnë më ose mund të jenë zvogeluar akoma. Nëse ka tregues të tilla, Banka çmon vlerën e rikuperueshme të aktivitet ose Njësise Gjeneruese të Parasë.

#### (q) Garancitë financiare

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës.

Detyrimet për garancitë financiare fillimisht njihen në vlerën e drejtë dhe vlera fillestare amortizohet mbi jetën e garancisë financiare. Detyrimi për garancinë mbahet me vlerën më të lartë midis vlerës me kosto të amortizuar dhe vlerës aktuale të pagesave të pritshme (kur pagesa nën një garanci është bërë e mundshme). Garancitë financiare përfshihen tek detyrimet e tjera.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (r) Depozita dhe detyrime të tjera financiare

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë pjesë e burimeve prej fondit debitor të Bankës.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë hyn në një marrëveshje për të riblere aktivin (ose një aktiv të njëjtë) me një cmim të pandryshuar për një datë të mëvonshme (marrëveshje repo), marrëveshja do të njihet si depozite, dhe aktivi në fjalë do vazhdojë të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Banka klasifikon instrumentat e kapitalit si detyrime financiare ose instrumente kapitali në përputhje me substancën e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht sipas vlerës së tyre të drejtë duke shtuar dhe kostot e drejtperdrejta të lidhura me transaksionin, dhe njihet në vazhdimësi me kosto të amortizuara, duke përdorur metodën e interest efektive.

#### (s) Provizione

Një provizion është njohur nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizioni matet duke skontuar fluksin e pritshëm të parave dhe duke përdorur një normë para tatimit që reflekton vlerën në kohë të parës sipas kushteve aktuale të tregut, dhe kur është e nevojshme, rreziqet që lidhen me këtë detyrim. Shpenzimi që lidhet me këtë provision paraqitet në vlerën neto prej rimbursimeve të mundshme në pasqyrën e të ardhurave.

#### (t) Përfitimet e pensionit

##### (i) Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Banka paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet e Sigurimeve Shoqërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuara për pensione. Kontributet për planin e pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzime kur ato ndodhin.

##### (ii) Leja vjetore e paguar

Banka njeh si detyrim shumë të përlogaritur të kostos që pritet të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

##### (iii) Sigurimet shëndetësore të punonjësve

Banka gjithashtu paguan kontribute të përcaktuara për sigurimin shëndetësor të punonjësve. Kontributi është i pagueshëm ndaj një kompanie sigurimi në raport me shërbimet e kryera në Bankë nga ana e punonjësve dhe është regjistruar si një shpenzim nën 'shpenzime të personelit'. Kontributet e paguara janë të regjistruar si detyrime.

#### (u) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë.

##### (i) Tatimi aktual mbi fitimin

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm vjetor. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në Pasqyrën e të Ardhurave Përmbledhëse për shkak të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshëm ose të zbritshëm në periudhat e ardhshme dhe zërat që nuk tatohen apo njihen asnjëherë si të zbritshëm.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin njihen në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Të ardhurat e tatueshme llogariten duke rregulluar fitimin para tatimit për shumën e të ardhurave shpenzimeve të caktuara, siç kërkohej nga ligji Shqiptar.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (u) Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

##### (ii) *Tatimi i shtyrë mbi fitimin*

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorura për qëllim fiskale. Detyrimet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme përveç rasteve kur tatimi i shtyrë vjen si rezultat i njohjes fillestare të një aktivi apo detyrimi që nuk ka të bëjë me një kombinim biznesi, dhe kur kryhet transaksioni ai nuk ndikon as fitimin kontabël dhe as fitimin apo humbjen tatimore.

Aktivitet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme, mbartjen e kreditit tatimor te paperdorur, në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të disponueshme, ndaj të cilave ato mund të shfrytëzohen, përveç rasteve kur aktivi tatimor i shtyrë që lidhet me diferenca të zbritshme të përkohshme vjen si rezultat i njohjes fillestare të një aktivi apo detyrimi që nuk ka të bëjë me një kombinim biznesi, dhe kur kryhet transaksioni ai nuk ndikon as fitimin kontabël dhe as fitimin apo humbjen tatimore.

Vlera kontabël neto e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në fund të çdo periudhe raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është e mundur që të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme në dispozicion për të lejuar që e gjitha ose një pjesë e aktivitetit të mund të rikuperohet. Aktivitet tatimore të shtyra që nuk janë njohur rivleresohen në fund të çdo periudhë raportuese dhe njihen deri në atë masë që fitimi i mundshëm tatimor do jetë i mjaftueshëm për të mbuluar aktivitet tatimore të shtyra.

Detyrimet dhe aktivitet e shtyra tatimore maten me normat e tatimit të cilat pritet të aplikohen në periudhën kur detyrimi do të shlyhet ose aktivi realizohet, bazuar në normat fiskale dhe ligjet fiskale të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit.

Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë mbi fitimin që njihet direkt në zërat e kapitalit regjistrohen në kapitalin e Bankës, ose në të ardhurat e tjera përmbledhëse dhe jo në fitim ose humbje.

Aktivitet tatimore të shtyra dhe detyrimet tatimore të shtyra mund të kompensohen nëse një e drejtë e detyrueshme me ligj ekziston për të kompensuar këto aktive dhe detyrime tatimore të shtyra ndaj të njëjtes njësi tatimore apo autoriteti tatimor.

#### (v) **Rezerva të kapitalit**

Rezervat e krijuara prej fondeve të kapitalit (të tjera fitime gjithëpërfshirëse) në pasqyrat financiare të Bankës përfshijnë:

- Rezerva për 'të vlefshme për tu shitur' e cila përbëhet prej ndryshimit në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vlefshme për t'u shitur.
- 'Rezerva ligjore', e cila përmban vlerën e rezervës ligjore krijuar sipas rregulloreve të Bankës së Shqipërisë (Shënimi 26).
- 'Rezerva rivlerësimi' e cila përfaqëson shumën që i është shtuar kapitalit të paguar të degës pas transformimit në filiar, duke përdorur kursin e këmbimit më 31 dhjetor 2011.

#### (w) **Informacion krahasues**

Shifrat krahasuese janë riklasifikuar aty ku është e përshtatshme për të qënë në pajtueshmëri me ndryshimet në prezantim në periudhën aktuale. Keto riklasifikime, gjithsesi, nuk kanë rezultuar në ndryshime të rëndësishme të përmbajtjes dhe formatit të informacionit financiar, sic është paraqitur në pasqyrat financiare.

#### (x) **Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime ende të pa miratuara**

Një numër standardesh, amendimesh dhe interpretimeve nuk kanë qënë ende efektive në fund të 31 dhjetorit 2013 dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasyrave financiare. Ato që mund të jenë me rëndësi për Bankën janë si më poshtë. Banka nuk planifikon ti adoptojë këto standarde dhe amendime më heret.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (x) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime ende të pa miratuara (vazhdim)

- **SNRF 9 Instrumentat financiarë (2013), SNRF 9 Instrumentat financiarë (2010) dhe SNRF 9 Instrumentat financiarë (2009) (së bashku, SNRF 9)**

SNRF 9 (2009) paraqet kërkesat e reja për klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. SNRF 9 (2010) prezanton shtesa që lidhen me detyrimet financiare. SNRF 9 (2013) paraqet kërkesat e reja për kontabilitetin mbrojtës (“*hedge accounting*”). BSNK aktualisht ka një projekt aktiv për të bërë ndryshime të limituara në kërkesat për klasifikimin dhe matjen sipas SNRF 9 si dhe të shtojë kërkesa të reja për të trajtuar zhvlerësimin e aktiveve financiare.

SNRF 9 (2009) paraqesin një ndryshim të rëndësishëm nga kërkesat ekzistuese të SNK 39 në lidhje me aktivet financiare. Standardi përmban dy kategori kryesore të matjes së aktiveve financiare; me kosto të amortizuar dhe me vlerë të drejtë. Një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse ai mbahet brenda një modeli biznesi i cili ka për objektiv të mbledhë flukse monetare, dhe kushtet kontraktuale të aktivit shkaktojnë flukse monetare në data të caktuara të cilat janë pagesa të principalit dhe të interesit mbi principalin e papaguar. Të gjitha aktivet e tjera financiare maten me vlerën e drejtë. Ky standard eliminon kategoritë ekzistuese për aktivet e mbajtura deri në maturim, të vlefshme për shitje dhe huatë dhe llogaritë e arkëtueshme në SNK 39. Për një investim në një instrument kapitali i cili nuk është mbajtur për tu tregtuar, standardi lejon një zgjedhje definitive në njohjen fillestare, mbi baza individuale mbi kuotat (“share by share basis”) për të paraqitur të gjitha ndryshimet nga vlera e drejtë e investimit në të ardhurat e tjera përmbledhëse. Asnjë shumë e përfshirë në të ardhurat e tjera përmbledhëse nuk do të riklasifikohet në fitim ose humbje në një datë të mëvonshme. Megjithatë, dividendët mbi investime të tilla do të njihen në fitim ose humbje dhe jo në të ardhura të tjera përmbledhëse, përveçse nëse në mënyrë të qartë ato përfaqësojnë një rikthim të pjesshëm të koston të investimit. Investimet në instrumentat e kapitalit për të cilat një entitet nuk ka zgjedhur të paraqesë ndryshimet e vlerës së drejtë në të ardhurat e tjera përmbledhëse do të maten me vlerën e drejtë dhe ndryshimet në vlerën e drejtë do të njihen në fitim ose humbje.

Standardi kërkon që derivativët e përfshirë në kontrata ku ka edhe një aktiv financiar që është objekt i standardit të mos ndahen; por instrumenti hibrid financiar të vlerësohet në tërësinë e tij nëse duhet të matet me koston e amortizuar apo me vlerën e drejtë.

SNRF 9 (2010) paraqet një kërkesë të re në lidhje me detyrimet financiare të dizenuara mbi opsionin e vlerës së drejtë për të prezantuar ndryshimet në vlerën e drejtë të cilat i atribuohen detyrimit të rezikut të kredisë (“*liability’s credit risk*”) në të ardhurat e tjera përmbledhëse dhe jo në fitim ose humbje. Përveç këtij ndryshimi, SNRF 9 (2010) mbart në një masë të madhe pa ndryshime thelbësore udhëzimet për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare nga SNK 39.

SNRF 9 (2013) prezanton kërkesa të reja për kontabilitetin mbrojtës (“*hedge accounting*”) të cilat e rradhisin atë më afër menaxhimit të rrezikut. Kërkesat e reja krijojnë një qasje të bazuar në parimet e kontabilitetit mbrojtës dhe adresojnë mungesën e konsistencës dhe dobësitë në modelin e kontabilitetit mbrojtës të paraqitur në SNK 39.

Data e detyrueshme e hyrjes në fuqi të SNRF 9 nuk është specifikuar por do të përcaktohet kur fazat e pazgjidhura të jenë përfunduar. Megjithatë aplikimi i SNRF 9 është i lejueshëm. Banka ka nisur procesin e vlerësimit të efektit të tij potencial por është në pritje të amendimeve të limituara para se vlerësimi të përfundojë. Duke pasur parasysh natyrën e operacioneve të Bankës, ky standard pritët të ketë një ndikim depërtues në pasqyrat financiare të Bankës.

- **Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (Amendim i SNK 32)**

Amendimet e SNK 32 sqarojnë kriteret e kompensimit të SNK 32 duke shpjeguar kur një entitet ka të drejtë legjitime kompensimi dhe kur shlyerja bruto është e barabartë me shlyerjen neto. Amendimet janë efektive për periudha vjetore duke filluar më 1 Janar 2014 ose më pas si dhe për periudha të përkohshme brenda këtyre periudhave vjetore. Aplikimi i më hershëm është i lejueshëm. Banka është ende në proces vlerësimi të efektit potencial nga adoptimi i amendimit të SNK 32.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (x) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime ende të pa miratuara (vazhdim)

##### Standarde të reja dhe ndryshime që nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës

###### • *SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara*

Më 12 Maj 2011, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit lëshoi SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara”. Qëllimi i SNRF 10 është të vendosë parimet për prezantimin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara kur entiteti kontrollon një ose më shumë entitete të tjera. Ndryshimi kryesor që solli SNRF 10 është përkufizimi i ri i parimit të kontrollit. Kontrolli është baza për përcaktimin se cilat entitete janë konsoliduar, pavarësisht tipit të entitetit. SNRF 10 prevalon ndaj kërkesave që lidhen me pasqyrat financiare të konsoliduara sipas SNK 27 “Pasqyrat Financiare Individuale dhe të Konsoliduara” dhe gjithashtu prevalon ndaj interpretimit 12 “Konsolidimi-Entitete me Qëllim Specifik” të Komitetit të Interpretimit të Standardeve (KIS).

Sipas përkufizimit të ri të kontrollit, një investitor kontrollon subjektin e investuar kur ai ekspozohet, apo ka të drejta ndaj kthimeve variabël prej përfshirjes së tij në investim dhe ka aftësinë të ndikojë këto kthime përmes pushtetit të tij ndaj të investuarit. Kështu, një investitor kontrollon të investuarin nëse dhe vetëm nëse investitori zotëron të gjitha sa më poshtë:

1. pushtetin ndaj të investuarit,
2. ekspozimin, të drejtat ndaj kthimeve variabël prej përfshirjes së tij te i investuari, dhe
3. aftësinë për të përdorur pushtetin e tij mbi të investuarin për të ndikuar shumën e kthimeve.

Pushteti vjen prej të drejtave ekzistuese që i japin investitorit aftësinë për të drejtuar aktivitetet e rëndësishme, si përsëmbull aktivitetet që ndikojnë në mënyrë domethënëse kthimet e të investuarit. Një investitor është i ekspozuar, ose ka të drejta ndaj kthimeve variabël prej përfshirjes së tij në investim kur kthimet e investitorit prej përfshirjes kanë mundësi të ndryshojnë si rezultat i performancës së të investuarit. Megjithatë një i investuar mund të kontrollohet vetëm prej një investitori, kthimet prej një të investuari mund të ndahen në më shumë se një palë. Kontrolli duhet të rivlerësohet nëse faktet dhe rrethanat tregojnë se ka ndryshime ndaj një apo më shumë prej këtyre tre elementëve të kontrollit.

SNRF 10 paraqet kushtet se si të aplikohet parimi i kontrollit në situata të ndryshme, përsëmbull kur të drejtat e votës apo të tjera të drejta të ngjashme i japin pushtet një investitori, kur të drejtat e votës nuk janë faktori kryesor për të përcaktuar se kush e kontrollon të investuarin, në situata që përfshijnë marrëdhëniet e agjentit ose kur investitori ka kontroll mbi aktivet specifike të të investuarit. SNRF 10 përfshin gjithashtu parimet kontabël për përgatitjen dhe prezantimin e pasqyrave financiare të konsoliduara, të cilat janë thelbësisht njëloj si ato që aktualisht aplikohen në kuadër të SNK 27 “Pasqyrat Financiare Individuale dhe të Konsoliduara”, respektivisht i ndryshuar.

###### • *SNRF 11 Marrëveshjet e përbashkëta*

Më 12 Maj 2011, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit lëshoi SNRF 11 “Marrëveshjet e Përbashkëta” që vendos parimet për raportimin financiar të entiteteve që kanë një interes në angazhime që kontrollohen bashkarisht. Kontrolli i përbashkët është ndarja e kontrollit të një marrëveshjeje, përmes marrëveshjes kontraktuale, që ekziston vetëm kur vendimet në lidhje me aktivitetet e rëndësishme kërkojnë aprovimin unanim të palëve që ndajnë kontrollin. Ka dy tipe të marrëveshjes së përbashkët sipas SNRF 11, si aktivitetet e përbashkëta dhe sipërmarrjet e përbashkëta. Klasifikimi varet prej të drejtave dhe detyrimeve të palëve në marrëveshje. Konkretisht, në aktivitetet e përbashkëta, palët që kanë kontroll të përbashkët në angazhim kanë të drejta ndaj aktiveve, dhe obligime për detyrimet që lidhen me angazhimin, ndërsa në sipërmarrjet e përbashkëta, ata kanë të drejta vetëm ndaj aktiveve neto të angazhimit.

Palët që kanë kontroll të përbashkët të një aktiviteti të përbashkët njohin në pasqyrat e tyre të konsoliduara dhe pasqyrat financiare individuale aktivet dhe detyrimet si edhe të ardhurat dhe shpenzimet që ata zotërojnë ose mbi të cilat kanë të drejta prej aktivitetit të përbashkët. Të njëjtat parime kontabël aplikohen edhe për palët në aktivitetet e përbashkëta që nuk kanë kontroll të përbashkët por kanë të drejta ndaj aktiveve dhe obligime për detyrimet që lidhen me aktivitetin e përbashkët.



# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (x) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime ende të pa miratuara (vazhdim)

**Standarde të reja dhe ndryshime që nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës**

- **SNRF 11 Marrëveshjet e përbashkëta (vazhdim)**

Palët që kanë kontroll të përbashkët në një sipërmarrje të përbashkët njohin interesat e tyre nga investimi duke përdorur metodën e kapitalit në përputhje me SNK 28 “Investimet në ortakëri dhe sipërmarrje të përbashkëta”. Alternativa për të konsoliduar proporcionalisht një sipërmarrje të përbashkët nuk është më e vlefshme. Një palë në një sipërmarrje të përbashkët që nuk ka kontroll ndaj sipërmarrjes së përbashkët i njeh interesat e saj në përputhje me SNK 39 (ose SNRF 9 nëse aplikohet), përveçse nëse ka ndikim domethënës ndaj sipërmarrjes së përbashkët, rast ky në të cilin duhet të njihen interesat përmes metodës së kapitalit.

- **SNRF 12 Paraqitja e Interesave në Entitete të Tjera**

Më 12 Maj 2011, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit lëshoi SNRF 12 i cili përcakton informacionin që entiteti raportues duhet të paraqesë në lidhje me interesat e tij në entitete të tjera. Një interes në një entitet tjetër i referohet përfshirjes kontraktuale ose jokontraktuale që e ekspozon entitetin ndaj kthimeve variabël prej performancës së një entiteti tjetër. SNRF 12 liston paraqitjet e kërkuara në varësi të natyrës së interesit në entitetin tjetër, si përshembull a) njësitë në varësi, b) angazhimet e përbashkëta, c) ortakëritë dhe d) entitetet e strukturuar të pakonsoliduara.

Entitetet e strukturuar janë ato që janë dizenuar në mënyrë të tillë që të drejtat e votës apo të tjera të drejta të ngjashme nuk përbëjnë një faktor kryesor për të vendosur se kush e kontrollon njësinë (domethënë aktivitetet kryesore drejtohen përmes marrëveshjeve kontraktuale).

SNRF 12 nuk aplikohet në pasqyrat financiare individuale në të cilat aplikohet SNK 27 “Pasqyrat financiare individuale”. Megjithatë, një entitet me interesa në entitete të strukturuar, të pakonsoliduara që përgatisin vetëm pasqyra financiare individuale do t’i përfshijë kërkesat për paraqitje të SNRF 12 që kanë të bëjnë me entitetet e strukturuar të pakonsoliduara në pasqyrat financiare.

- **Ndryshime të SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta dhe SNRF 12 Paraqitja e Interesave në Entitete të Tjera**

Më 28 Qershor 2012, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit lëshoi një amendim ndaj kërkesave tranzitore të standardeve të mësipërme. Amendimi qartëson se “data e zbatimit fillestar” është fillimi i periudhës së raportimit vjetor në të cilin SNRF 10 aplikohet për herë të parë. Në rast se përfundimi i konsolidimit i arritur në datën e aplikimit fillestar është i ndryshëm krahasuar me përfundimin nëse aplikohen SNK 27 dhe interpretimet e KIS 12, vetëm periudha krahasuese që paraprin duhet të rregullohet në retrospektivë. Paraqitja e informacionit krahasues të rregulluar për periudhat më të hershme lejohet por nuk kërkohet. Një përjashtim i ngjashëm që lidhet me paraqitjen e informacionit krahasues të rregulluar për periudhat e mëparshme jepet edhe në kërkesat tranzitore të SNRF 11 dhe 12. Gjithashtu, paraqitjet që lidhen me entitetet e strukturuar, të pa konsoliduara nuk kërkohen për ndonjë periudhë përpara vitit të parë të aplikimit të SNRF 12.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar

#### (a) Një vështrim i përgjithshëm

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozon Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- Rreziku i kredisë
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut
- Risku operacional;

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj çdo risku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe manaxhimin e riskut, dhe manaxhimin e kapitalit të Bankës.

#### *Struktura e administrimit të rrezikut*

Bordi Drejtues ka përgjegjësinë për ndërtimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut. Ne permblushjen e kesaj pergjegjesie Bordi Drejtues ndihmohet nga Komiteti i Riskut. Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të Komitetit të Riskut përcaktohen në "Rregullat dhe Rregulloret" e Komitetit të rrezikut, në bazë të procedurave të brendshme të miratuara dhe të zbatuara nga Banka në përputhje me dispozitat e ligjit dhe të kuadrit rregullator.

Bordi i drejtorëve ka autorizuar komitete të ndryshme për qeverisjen e rreziqeve si më poshtë:

- Rreziku i tregut, duke përfshirë normën e interesit dhe riskun e likuiditetit: Komiteti i Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO);
- Rreziku i kredise: Komiteti i Kreditit, Komiteti i Menaxhimit të rrezikut dhe Rënies në Vlerë dhe Komiteti i Dispozitave; dhe
- Risku operacional: Komiteti i rrezikut Operacional.

Kuadri për manaxhimin e riskut përshkruan perqasjet e ndjekura nga Banka persa i perket kerkesave per kapitalin rregullator te percaktuara sipas Basel II/Direktives per Kerkesa per Kapital dhe kuadrit rregullator te vendit. Banka ka adoptuar nje perqasje te plote persa i perket manaxhimit te riskut. Llojet e risqeve nuk manaxhohen ne menyre te pavarur nga njeri-tjetri, perkundrazi, mbi nje baze te unifikuar qe merr parasysh mundesine e mbivendosjes se risqeve me njeri-tjetrin. Gjatë proceseve të strategjisë të biznesit, theks i veçantë është vendosur në vëzhgimin e rreptë dhe përcaktimin e kufijve të pranueshëm të rrezikut. Departamenti i Manaxhimit të Riskut është i pavarur nga të gjitha njesitë në ngarkim për aktivitetet Bankare dhe investuese. Kuadri i manaxhimit të riskut të Bankës është dinamik; ai zhvillohet në përgjigje të ndryshimeve në objektivat strategjike dhe kushtet e brendshme dhe të jashtme.

#### *Paqendrueshmëria në tregjet financiare globale dhe shqiptare.*

Banka operon në kushtet e një krize ekonomike dhe financiare që po zhvillohet në mënyrë dinamike. Shtrirja e saj e metejshme mund të rezultojë në ndikime negative në pozicionin financiar të Bankës. Drejtimi i Bankës kryen monitorime ditore të pozicionit të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe zhvillimeve në tregjet financiare ndërkombëtare, duke aplikuar praktikën me të mira Bankare. Drejtimi i Bankës në bazë të analizës së përfitueshmërisë, likuiditetit dhe kostos së fondeve, merr masat e duhura në lidhje me kreditimin, tregjet (normat e interesit) dhe riskun e likuiditetit, duke limituar në këtë mënyrë ndikimet negative të mundshme që vijnë nga kriza ekonomike, financiare globale. Në këtë mënyrë Banka i përgjigjet zhvillimeve në mjedisin e tregut, duke mbajtur një nivel kapitali dhe një pozicion likuiditeti të qëndrueshëm.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

---

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Bankës nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti në kohe apo plotesisht. Ky risk vjen nga mundësia që një debitor nuk ka dëshirën të shlyejë detyrimet ose aftësinë e tij për të shlyer detyrimin është përkeqësuar duke rezultuar në humbje ekonomike për Bankën. Vec kësaj, humbjet rezultojnë edhe nga pakesimi në vlerën e portofolit për shkak të përkeqësimit aktual ose të perceptuar të cilësive të kredive të huamarrësit.

Rreziku i kredive konsiderohet risku më i rëndësishëm për Bankën.

Banka njeh nevojën për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar riskun e kredive të qenesishëm në aktivitetet e saj të huadhenies me pakice dhe shumice, si edhe për të përcaktuar që Banka mban kapital të pershtatshëm për t'u mbrojtur nga risku dhe ky risk kompensohet në mënyrë të pershtatshme. Banka synon që të mbajë ekspozimet e riksut të kredisë brenda niveleve të pranueshme. Banka ka autorizuar dhe themeluar komitetet respektive për të mbikqyrur riskun e kredive. Komiteti i rrezikut është përgjegjës për mbikqyrjen e kuadrit për manaxhimin e riskut të kredive, Komiteti i themeluar i Kredive dhe Departamenti i Kredive janë përgjegjës për mbikqyrjen e aktiviteteve të lidhura me riskun e kredive, Komiteti i Manaxhimit të Riskut dhe Departamenti i Manaxhimit të Riskut janë përgjegjës për propozimin e politikave dhe procedurave të kredive, Komiteti i Auditimit dhe Departamenti i Pavarur i Auditit të Brendshëm janë përgjegjës për t'u siguruar që praktikatat e riskut të kredive janë të mjaftueshme dhe të pershtatshme për aktivitetin e ndërmarrjes së riskut të kredive.

Gjatë vitit 2013 Banka ka rishikuar politiken e kreditimit në përputhje me zhvillimet ekonomike dhe financiare vendase dhe ndërkombëtare, dhe në përputhje me disa ndryshime në kuadrin ligjor dhe rregullator.

Banka, në mënyrë që të manaxhojë në mënyrë efektive riskun e kredive ka zhvilluar metodologji specifike dhe sisteme për të identifikuar dhe vlerësuar riskun e kredive. Këto sisteme dhe metodologji zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me zhvillimet makroekonomike, ligjore dhe rregullatore si edhe bazuar në zhvillimet strukturore dhe sektoriale të ekonomisë.

Mjete kryesore për identifikimin dhe vlerësimin e riskut të kredive nga huadhenia me shumice dhe pakice janë “rating-u” i rrezikut të kredive dhe sistemet e vlerësimit me shkallë. Si sistemet e vlerësimit me shkallë, ashtu edhe ato të “rating-ut” janë subjekt i kontrolleve të vazhdueshme të cilësive për të siguruar në çdo kohë efektivitetin e tyre. Gjatë vitit 2013 Banka ka vlerësuar në mënyrë sasiore dhe cilësore këto modele dhe i ka përmirësuar ato në përputhje me ndryshimet në mjedisin ekonomik dhe financiar.

Gjithashtu Banka kryen periodikisht “stress-test-e” në mënyrë që të vlerësojë dobësinë e saj ndaj ngjarjeve të mundshme të ardhshme siç janë ndryshimet në mjedisin ekonomik apo financiar të cilat mund të kenë ndikime të pafavorshme në ekspozimet e kredive dhe aftësinë e Bankës për t'i përballuar këto ndryshime. Gjithashtu, rezultatet e këtyre testeve mund të përdoren për të optimizuar më tej monitorimin e portofolit të riskuar.

Banka vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka evidencë të zhvlerësimit në përputhje me parimet e përgjithshme dhe metodologjinë e përcaktuar në SNK 39 dhe udhëzimin përkatës të implementimit si edhe Parimet e Politikës së Provigjonimit të Grupit.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

##### Ekspozimi maksimal bruto

	Shënime	Kategoria	2013	2012
Arka dhe Banka Qendrore	12	Standard	9,959,367	6,526,358
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	13	Standard	7,652,965	7,964,663
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	17	<i>Si më poshtë</i>	34,709,045	37,504,852
Letra me vlerë të tregtueshme	14	Standard	-	2,174,997
Aktive financiare të vlefshme për shitje	16	Standard	20,605,947	8,930,706
Aktive financiare mbajtur deri në maturim	15	Standard	9,160,674	15,855,918
			<b>82,087,998</b>	<b>78,957,494</b>
Angazhime për kredi të patërhequra	28	Standard	710,846	606,635
Letër kredi	28	Standard	32,310	2,024
Garanci dhënë në favor të klientëve	28	Standard	724,133	736,087
			<b>1,467,289</b>	<b>1,344,746</b>
<b>Gjithsej ekspozimi, para zhvlerësimit</b>			<b>83,555,287</b>	<b>80,302,240</b>

Kategoria standarde përfaqëson aktive që nuk janë me vonesë e as nuk janë zhvlerësuar.

Tabela më poshtë tregon ekspozimin neto të huave dhe paradhënieve dhënë klientëve deri me 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012 të ndara sipas portofolit të zhvlerësimit individual dhe atij kolektiv:

	2013	2012
<b>Vlera bruto:</b>		
As me vonesë, as te zhvlerësuar	15,761,780	14,191,502
Me vonesë por jo të zhvlerësuar	3,918,442	6,064,839
Të zhvlerësuar kolektivisht	1,605,205	1,343,961
Të zhvlerësuar individualisht	13,461,487	15,943,956
Komisionet e shtyra te disbursimit te kredive	(37,869)	(39,406)
	<b>34,709,045</b>	<b>37,504,852</b>
Fondi individual për zhvlerësim	(2,228,198)	(1,884,650)
Fondi kolektiv për zhvlerësim	(620,154)	(505,531)
	<b>(2,848,352)</b>	<b>(2,390,181)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>	<b>31,860,693</b>	<b>35,114,671</b>

Kreditë e zhvlerësuar kolektivisht janë të detajuara si më poshtë:

<b>Të zhvlerësuar kolektivisht</b>	<b>2013</b>	<b>2012</b>
Kreditë nën 100.000 euro dhe me vonesa mbi 90 ditë		
Kredi biznesi	55,974	145,765
Kredi hipotekare	1,331,597	995,081
Kredi te konsumatorit dhe kartat e kreditit	217,633	203,115
<b>Vlera bruto</b>	<b>1,605,204</b>	<b>1,343,961</b>
Fond provizioni për humbjet nga zhvlerësimi	(620,154)	(505,531)
<b>Vlera kontabël neto</b>	<b>985,051</b>	<b>838,430</b>

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

##### *Kredi me vonesë*

Një aktiv financiar është me vonesë nëse borxhi i palës tjetër është me vonesë më shumë se një ditë.

##### *Kredi jo performuese*

Një kredi konsiderohet jo-performuese nëse është me vonesë me më shumë se 90 ditë ose është në ndjekje ligjore. Një kredi nuk konsiderohet më si jo-performuese nëse një prej kushteve të mëposhtme arrihet:

- Rinegoci i termave të marrëveshjes fillestare të kredisë dhe ristrukturim
- Ripagim i shumës në vonesë prej mbi 90 ditë.

##### *Kredi të zhvlerësuara*

Rastet e kredive më poshtë përcaktohen si të zhvlerësuara:

- a. Kredi për të cilat shuma e zhvlerësimit llogaritet mbi bazë vlerësimi individual
- b. Kredi të ristrukturuara për të cilat llogaritet zhvlerësim kolektiv.

##### *Fondi për zhvlerësim*

Banka vendos një fond për humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar ose të klasifikuara si të mbajtura deri në maturim që përfaqësojnë parashikimin e saj për humbjet e ngjara në kreditë dhe portofolin e mbajtur deri në maturim. Elementët kryesorë të këtij fondi janë elementi i humbjeve specifike që lidhet me ekspozimet individualisht të rëndësishme dhe elementi i humbjeve kolektive që lidhet me kreditë e biznesit të sektorit të tregtisë me pakicë dhe kreditë hipotekore dhe konsumatore. Për më tepër, kreditë që vlerësohen individualisht për zhvlerësim dhe nuk zhvlerësohen përfshihen në grupe, bazuar në karakteristikat e ngjashme të riskut të kredisë, dhe vlerësohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim.

Aktivet e mbajtura me vlerë të drejtë përmes humbjes dhe fitimit nuk janë subjekt i testit të zhvlerësimit sepse matja me vlerë të drejtë reflekton cilësinë e kreditit të çdo aktivi.

##### *Kreditë e ristrukturuara*

Këto janë rastet e rinegociimit të termave fillestarë të një marrëveshje kredie për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij kontraktuale. Totali i kredive të ristrukturuara më 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 është si më poshtë:

<b>Kredi të ristrukturuara</b>	<b>2013</b>	<b>2012</b>
As me vonesë, as të zhvlerësuara	220,284	168,868
Me vonesë por jo të zhvlerësuara	197,008	134,972
Të zhvlerësuara	1,983,363	1,765,588
<b>Vlera bruto</b>	<b>2,400,655</b>	<b>2,069,428</b>
Fondi i zhvlerësimit individual	(30,738)	(27,171)
Fondi i zhvlerësimit kolektiv	(20,079)	-
<b>Vlera kontabël</b>	<b>2,349,838</b>	<b>2,042,257</b>

##### *Kreditë e fshira*

Kreditë e fshira përkufizohen si një zvogëlim permanent i borxhit, si rezultat i një vendimi ose marrëveshje ligjrisht detyruese (vendim gjyqi, marrëveshje kontraktuale etj.), e cila nuk është më e kërkueshme dhe rrjedhimisht, konsiderohet në mënyrë përfundimtare si e parikuperueshme, çka do të thotë se Banka në mënyrë përfundimtare dhe të pakthyeshme heq dorë nga e drejta për të kërkuar borxhin e fshirë, përveçse nëse (në rast të rënies dakord) konstatohet se termat e vendosur prej vendimit apo marrëveshjes së sipërpërmendur janë shkelur.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

##### *Kreditë e çregjistruara*

Kreditë e çregjistruara përcaktohen si reduktimi kontabël i një borxhi, që nuk do të thotë heqje dorë nga e drejta ligjore përkundërt debitorit, ndaj borxhi mund të rikuperohet. Propozimet për çregjistrim të një pjese apo të të gjithë borxhit mund të parashtrohen në komitetin kompetent me kushtin që veprimet e mëposhtme të jenë ndërmarrë:

- Marrëveshjet përkatëse me klientët janë përfunduar
- Urdhërpagesat janë lëshuar përkundërt palëve në detyrim
- Procedura për regjistrimin e barrave të detyrueshme ka filluar
- Të paktën një prej pasurive të patundshme është dërguar në ankand, në mënyrë që pretendimet e privileguara (përmes listës finale të kreditorëve prioritarë) dhe si rrjedhojë, humbjet e mundshme të Bankës të finalizohen.
- Është llogaritur provigjoni i njëjtë për zhvlerësim të paktën në tremujorin që i paraprin tremujorit të propozimit për çregjistrim.

<i>Kredi të çregjistruara</i>	<b>Hipotekore</b>	<b>Konsumatore</b>	<b>Karta krediti</b>	<b>Koorporatë</b>	<b>Total</b>
<b>Më 1 Janar 2012</b>	<b>359,023</b>	<b>56,907</b>	<b>86,589</b>	<b>293,930</b>	<b>796,449</b>
Të fshira	28,764	3,379	1,245	223	33,611
Të rikuperuara	(38,891)	(5,831)	(15,867)	-	(60,589)
<b>Më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>348,896</b>	<b>54,455</b>	<b>71,967</b>	<b>294,153</b>	<b>769,471</b>
Të fshira	1,455	475	333	-	2,263
Të rikuperuara	(30,549)	(5,931)	(10,818)	-	(47,298)
<b>Më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>319,802</b>	<b>48,999</b>	<b>61,482</b>	<b>294,153</b>	<b>724,436</b>

Banka monitoron vazhdimisht portofolin e kredive të çregjistruara. Banka ka rikuperuar Lek 47,298 mijë (2012: Lek 60,589 mijë) gjatë vitit 2013.

##### *Kolaterali*

Banka mban kolaterale kundërt huave dhe paradhëniesve dhënë klienteve në formën e hipotekave mbi pasuritë e paluajtshme, të drejta të tjera të regjistruara mbi aktive, si dhe garanci. Përlllogaritja e vlerës së drejtë bazohet në vlerën e kolateralit në momentin e huadhenies, dhe perditesohet në mënyrë të vazhdueshme sipas llojit të kolateralit. Përgjithësisht nuk mbahen kolaterale për hua dhënë Bankave, me përjashtim të rastit kur letrat me vlerë janë të mbajtura si pjese e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes dhe të aktivitetit të huamarrjes së letrave me vlerë. Përgjithësisht nuk mbahen kolaterale kundërt letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim.

Një vlerësim i vlerës së drejtë të kolateraleve dhe titujve të tjerë garantues të mbajtur përkundërt kredive dhe paradhëniesve ndaj klientëve paraqitet më poshtë:

	<b>2013</b>	<b>2012</b>
<b>Përkundërt kredive individualisht të zhvlerësuar:</b>	<b>74,045,962</b>	<b>194,903,466</b>
Prona	70,363,140	190,788,340
Mjete monetare	-	-
Të tjera	3,682,822	4,115,126
<b>Përkundërt kredive kolektivisht të zhvlerësuar::</b>	<b>65,803,267</b>	<b>17,993,008</b>
Prona	64,569,536	17,238,622
Mjete monetare	-	1,754
Të tjera	1,233,731	752,632
<b>Total</b>	<b>139,849,229</b>	<b>212,896,474</b>

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

##### *Përqëndrimi sipas vendndodhjes*

Perqendrimi sipas vendndodhjes për huatë dhe paradhëniet matet bazuar në vendndodhjen e subjektit Bankar që mban aktivin, i cili ka një korrelacion të lartë me vendndodhjen e huamarrësit. Perqendrimi sipas vendit për letrat me vlerë të tregtueshme dhe të investimit matet bazuar në vendndodhjen lëshuesit të letrës me vlerë.

	2013			2012		
	Shqipëri	Shtete të tjera	Totali	Shqipëri	Shtete të tjera	Totali
Arka dhe Banka Qendrore	9,959,367	-	9,959,367	6,526,358	-	6,526,358
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	823,678	6,829,287	7,652,965	410,043	7,554,620	7,964,663
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve, neto	29,962,696	1,897,997	31,860,693	33,224,916	1,889,755	35,114,671
Letra me vlerë të tregtueshme	-	-	-	638,234	1,536,763	2,174,997
Aktive financiare të vlefshme për shitje (VPS)	10,037,385	10,568,562	20,605,947	-	8,930,706	8,930,706
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (MDM)	7,655,400	1,505,274	9,160,674	11,667,996	4,187,922	15,855,918
	<b>58,438,526</b>	<b>20,801,120</b>	<b>79,239,646</b>	<b>52,467,547</b>	<b>24,099,766</b>	<b>76,567,313</b>

Kategoria 'Shtete të tjera' përfaqëson palë të vendosura në shtete Europiane, me përjashtim të një bono thesari prej 886,457 mijë lekë të klasifikuar si letër me vlerë e vlefshme për shitje që është lëshuar në Shtetet e Bashkuara.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

##### Analiza e vlerësimit

Analiza e vlerësimit për tepricat me Banken e Shqipërisë, Kredite dhe paradhëniet për Bankat, dhe Letrat me Vlerë të Borxhit, për 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012 janë paraqitur me poshte:

2013						2012					
Vlerësimi	Banka Qendrore	Kredi dhe paradhënie bankave	Letra me vlerë VPS	Aktive financiare MDM	Totali	Banka Qendrore	Kredi dhe paradhënie bankave	Letra me vlerë të tregtueshme	Letra me vlerë VPS	Aktive financiare MDM	Totali
AAA	-	-	2,313,238	-	2,313,238	-	-	-	2,279,386	-	2,279,386
AA+	-	-	1,576,872	-	1,576,872	-	-	1,536,763	-	-	1,536,763
AA	-	-	990,784	-	990,784	-	-	-	1,515,389	-	1,515,389
AA-	-	-	1,206,678	-	1,206,678	-	-	-	-	-	-
A+	-	-	1,345,252	-	1,345,252	-	38,553	-	1,061,548	-	1,100,101
A	-	-	-	-	-	-	-	-	2,887,616	-	2,887,616
BBB+	-	-	695,119	-	695,119	-	2,768,800	-	1,186,767	-	3,955,567
BB+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1,438,592	1,438,592
BBB	-	615,457	-	-	615,457	-	-	-	-	-	-
B+	-	-	-	-	-	6,526,358	-	638,234	-	11,667,996	18,832,588
B	9,959,367	-	10,037,385	7,655,401	27,652,153	-	-	-	-	-	-
BB-	-	-	-	1,505,273	1,505,273	-	-	-	-	-	-
B-	-	6,212,510	1,228,439	-	7,440,949	-	-	-	-	2,749,330	2,749,330
CCC	-	-	1,212,180	-	1,212,180	-	4,747,267	-	-	-	4,747,267
Të parenditura	-	824,998	-	-	824,998	-	410,043	-	-	-	410,043
	<b>9,959,367</b>	<b>7,652,965</b>	<b>20,605,947</b>	<b>9,160,674</b>	<b>47,378,953</b>	<b>6,526,358</b>	<b>7,964,663</b>	<b>2,174,997</b>	<b>8,930,706</b>	<b>15,855,918</b>	<b>41,452,642</b>



# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

##### Perqendrimi sipas industrise

<i>Hua dhe paradhënie dhënë klientëve</i>	<b>2013</b>	<b>% ndaj Totalit</b>	<b>2012</b>	<b>% ndaj Totalit</b>
Institucione financiare	1,897,997	6%	1,889,755	5%
Sektori publik	1,404,344	4%	1,398,191	4%
Industri prodhimi	4,757,415	15%	4,808,493	14%
Pasuri të paluajtshme	145,664	0%	56,650	0%
Ndërtim	3,967,815	12%	3,689,162	11%
Tregti me shumicë dhe pakicë	5,568,881	17%	6,001,904	17%
Transport	962,779	3%	953,921	3%
Transport mallrash	36,726	0%	-	-
Hoteleri/Turizëm	369,481	1%	3,109,435	9%
Shërbime	411,613	1%	724,857	2%
Sektorë të tjerë	530,553	2%	80,165	0%
Kredi hipotekare	9,484,890	30%	10,038,642	29%
Kredi të konsumatorit/ kartat e kreditit	1,222,043	4%	941,942	3%
Kredi biznesi dhënë klientëve	3,986,713	13%	3,851,141	11%
Tarifat e shtyra të disbursimit të kredisë	(37,869)	(0%)	(39,406)	(0%)
Fondi për humbje nga zhvlerësimi	(2,848,352)	(9%)	(2,390,181)	(7%)
	<b>31,860,693</b>	<b>100%</b>	<b>35,114,671</b>	<b>100%</b>

#### (c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është risku që një letër me vlerë apo një aktiv i caktuar të mos tregtohet dot me shpejtësi të mjaftueshme në treg në mënyrë që të parandalohet humbja apo të arrihen fitimet e kerkuara. Rreziku i likuiditetit është risku me të cilin perballen të ardhurat ose kapitali, që rrjedh prej aftësive të Bankes për të permbushur detyrimet e saj brenda afatit të shlyerjes, pa pesuar humbje në nivele të papranueshme. Rreziku i likuiditetit rrjedh gjithashtu nga deshtimi i Bankes për të njohur ose adresuar ndryshimet në kushtet e tregut që ndikojnë aftësinë për të likuiduar aktivet në një periudhë afatshkurter (një muaj) dhe me humbje minimale në vlerë.

Bordi Drejtues me ndihmen e Komitetit të Riskut ia ka caktuar manaxhimin e likuiditetit dhe manaxhimin e riskut të likuiditetit Komitetit të Aktiveve dhe Detyrimeve. Kuadri i Manaxhimit të Likuiditetit kërkon ekzaminimin e likuiditetit të aktiveve dhe detyrimeve si edhe të profilit të likuiditetit. Ai gjithashtu përfshin monitorimin efektiv dhe procedurat e raportimit të cilat lejojnë dhenien ditore të informacionit mbi riskun e likuiditetit dhe pozicionin e likuiditetit. Pozicioni i likuiditetit të Bankes është subjekt i “stress-testeve” periodike dhe analizave të skenareve dhe provizione krijohen përmes krijimit të Planit Kontingjent të Financimit. Procedurat monitoruese dhe raportuese gjatë vitit 2012 janë përditësuar në përputhje me zhvillimet e tregut, kërkesat e kuadrit rregullator dhe politikat e procedurat e brendshme. Banka, gjithashtu, ka rishikuar dhe aprovuar Planin Kontingjent të Financimit, i cili përcakton udhëzimet kryesore dhe drejtimin për identifikimin dhe manaxhimin e problemeve serioze të likuiditetit. Është përcaktuar një listë e treguesve të hershëm paralajmërues dhe niveleve perkatëse të sinjalizimit. Komiteti i Aktiveve dhe Detyrimeve është përgjegjës për aktivizimin e këtij plani.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

##### Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Kategorizimi i aktiveve dhe detyrimeve sipas riskut të tyre të likuiditetit është si vijon:

<b>31 Dhjetor 2013</b>	<b>Deri në 1 muaj</b>	<b>1 deri në 3 muaj</b>	<b>3 deri në 12 muaj</b>	<b>1 deri në 5 vjet</b>	<b>Mbi 5 vjet</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivet Financiare</b>						
Arka dhe Banka Qendrore	10,992,540	-	-	-	-	10,992,540
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	7,652,965	-	-	-	-	7,652,965
Aktive financiare të vlefshme për shitje	17,211,363	1,212,179	-	-	2,182,405	20,605,947
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	7,168,105	-	-	1,505,274	487,295	9,160,674
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	776,855	1,934,595	5,862,822	10,995,406	12,291,015	31,860,693
Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale	-	-	-	-	985,108	985,108
Aktive të tjera dhe tatimi i parapaguar	-	-	557,650	-	-	557,650
<b>Totali</b>	<b>43,801,828</b>	<b>3,146,774</b>	<b>6,420,472</b>	<b>12,500,680</b>	<b>15,945,823</b>	<b>81,815,577</b>
<b>Detyrime Financiare</b>						
Detyrime ndaj bankave	124,381	-	-	-	-	124,381
Detyrime ndaj klientëve	22,746,767	7,249,077	24,531,505	1,781,103	11,126,562	67,435,014
Borxhi i varur	-	10,754	-	2,243,200	-	2,253,954
Detyrim tatimor i shtyre	43,251	-	-	-	-	43,251
Detyrime të tjera	-	-	405,897	-	-	405,897
Kapitali neto i aksionerëve	-	-	-	-	11,553,080	11,553,080
<b>Totali</b>	<b>22,914,399</b>	<b>7,259,831</b>	<b>24,937,402</b>	<b>4,024,303</b>	<b>22,679,642</b>	<b>81,815,577</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>20,887,429</b>	<b>(4,113,057)</b>	<b>(18,516,930)</b>	<b>8,476,377</b>	<b>(6,733,819)</b>	<b>-</b>
<b>Kumulativi</b>	<b>20,887,429</b>	<b>16,774,372</b>	<b>(1,742,558)</b>	<b>6,733,819</b>	<b>-</b>	

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

#### Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

31 Dhjetor 2012	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 12 muaj	1 deri nw 5 vjet	Mbi 5 vjet	Totali
<b>Aktivët Financiare</b>						
Arka dhe Banka Qendrore	7,458,976	-	-	-	-	7,458,976
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	7,964,663	-	-	-	-	7,964,663
Letra me vlerë të tregtueshme	728,087	-	-	-	1,446,910	2,174,997
Aktive financiare të vlefshme për shitje	7,144,565	-	-	-	1,786,141	8,930,706
Aktive financiare mbajtur deri në maturim	12,294,252	1,438,664	1,363,007	-	759,995	15,855,918
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	8,382	309,500	780,203	6,066,863	27,949,723	35,114,671
Aktivët afatgjata material dhe jomateriale	-	-	-	-	1,158,660	1,158,660
Aktive të tjera dhe tatimi i parapaguar	-	-	788,724	-	-	788,724
<b>Totali</b>	<b>35,598,925</b>	<b>1,748,164</b>	<b>2,931,934</b>	<b>6,066,863</b>	<b>33,101,429</b>	<b>79,447,315</b>
<b>Detyrime Financiare</b>						
Detyrime ndaj bankave	-	-	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	29,329,567	8,238,352	18,289,724	158,108	8,764,561	64,780,312
Borxhi i varur	-	10,302	-	-	2,233,440	2,243,742
Detyrim tatimor i shtyre	87,213	-	-	-	-	87,213
Detyrime të tjera	-	-	593,308	-	-	593,308
Kapitali neto i aksionerëve	-	-	-	11,742,740	-	11,742,740
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitali</b>	<b>29,416,780</b>	<b>8,248,654</b>	<b>18,883,032</b>	<b>11,900,848</b>	<b>11,998,001</b>	<b>79,447,315</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>6,182,145</b>	<b>(6,500,490)</b>	<b>(15,951,098)</b>	<b>5,833,985</b>	<b>22,103,428</b>	<b>-</b>
<b>Kumulativ më 31 December 2012</b>	<b>6,182,145</b>	<b>(318,345)</b>	<b>(16,269,443)</b>	<b>(22,103,428)</b>	<b>-</b>	

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është risku për një rënie në vlerën ekonomike ose në të ardhurat e raportuara për shkak të lëvizjeve të përgjithshme në treg dhe përfshin llojet kryesore: rrezikun e normës së interesit, rrezikun nga kurset e këmbimit, rrezikun e cmimit të kapitalit dhe të cmimeve të të mirave.

Bordi Drejtues ka deleguar rregullimin e rrezikut të tregut tek Komiteti i Riskut, i cili është përgjegjës për të dhënë mbështetje dhe mbikëqyrje të kuadrit të rrezikut të tregut duke vendosur nivele të pranueshme të rrezikut të tregut dhe duke siguruar se Banka merret të gjitha masat e nevojshme për të identifikuar, vlerësuar, monitoruar dhe kontrolluar rreziqet e tregut. Gjithashtu Boardi Drejtues ka autorizuar Komitetin e Aktiveve dhe Pasiveve (ALCO) për të miratuar udhëzime dhe strategji të administrimit të rrezikut të tregut.

#### *Administrimi i risqeve të tregut*

Mjeti kryesor që përdoret për të matur dhe kontrolluar rrezikun e tregut brenda portofoleve tregtare të Bankës është Vlera në Rrezik (VnR). VnR e portofolit tregtar është vlerësimi i humbjes me të madhe të bankës që pritët të ndodhë në kushte normale të tregut, në portofolin tregtar për një periudhë të caktuar kohore (periudha e mbajtjes) si pasojë e një lëvizje negative në treg me një nivel besueshmërie të caktuar.

Matja e rrezikut të tregut i cili vjen nga pozicionet valutore VnR llogaritet në baza ditore me nivel besueshmërie 99% e për një periudhë mbajtjeje 1 (një) dhe 10 (dhjetë) dite, bazuar në të dhëna nga periudha e mëparshme prej 250 ditësh tregtimi duke përdorur simulim historik.

Të gjitha ekspozimet e thesarit janë subjekt i kufijve të caktuar. Kufijte e pozicioneve të hapura, kufijte e humbjes maksimale (humbja stop) dhe kufijte e kundërpasive janë të përcaktuara. Pozicionet monitorohen në baza ditore dhe rishikohen nëse janë brenda kufirit të mbuluar në përqindje dhe për cdo tejkalim.

Portofoli VPS administrohet në baza të vlerës së drejtë. Letrat me vlerë VPS dhe MDM monitorohen me anë të hendeut të normave të interesit, sipas të cilave aktivet dhe pasivet klasifikohen në segmente kohore bazuar në periudhën e ricimit.

Analizat perkatese kryhen nga Departamenti i Administrimit të Riskut dhe prezantohen në mbledhjet e ALCOs në Alpha Bank Albania, që gjithashtu ka autoritet për të administruar çështjet e rreziqeve të tregut.

ALCO është përgjegjës për zbatimin e strategjisë së administrimit të rrezikut dhe për rishikimin ditor të zbatueshmërisë së saj.

#### (e) Rreziku financiar në regjistrin bankar

Lidhur me ekspozimin ndaj rreziqeve të tregut, Banka ben dallim midis rrezikut tregtar dhe regjistrit bankar.

#### *Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit – regjistri bankar*

Rreziku kryesor ndaj të cilit portofolet e regjistruar ekspozohen është humbja e mundshme që rrjedh prej ndryshimeve në flukset e ardhshme monetare për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut.

ALCO është njesia monitoruese për pajtueshmëri me limitet dhe ndihmohet nga sektori i Thesarit gjatë aktiviteteve monitoruese ditore. Një përmbledhje e pozicioneve të hapura lidhur me interesat e portofoleve jotregtare është si vijon:

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (e) Rreziku financiar ne regjistrin bankar (vazhdim)

*Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit – regjistri bankar (vazhdim)*

31 dhjetor 2013	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Pa interes	Totali
<b>Aktive financiare</b>						
Arka dhe Banka Qendrore	2,824,000	-	-	-	8,168,540	10,992,540
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	7,650,806	-	-	-	2,159	7,652,965
Aktive financiare mbajtur deri në maturim	899,450	2,870,146	5,245,624	-	145,454	9,160,674
Aktive financiare të vlefshme për shitje	1,447,783	5,582,279	11,501,334	1,901,797	172,754	20,605,947
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	12,448,205	8,453,519	2,329,578	6,977,463	1,651,928	31,860,693
Aktive te tjera	-	-	-	-	1,542,758	1,542,758
<b>Totali</b>	<b>25,270,244</b>	<b>16,905,944</b>	<b>19,076,536</b>	<b>8,879,260</b>	<b>11,683,593</b>	<b>81,815,577</b>
<b>Detyrime financiare</b>						
Detyrime ndaj bankave	124,381	-	-	-	-	124,381
Detyrime ndaj klientëve	33,383,327	7,838,461	23,850,577	1,751,864	610,785	67,435,014
Borxhi i varur	-	2,243,200	-	-	10,754	2,253,954
Detyrime te tjera	-	-	-	-	449,148	449,148
Kapitali	-	-	-	-	11,553,080	11,553,080
<b>Totali</b>	<b>33,507,708</b>	<b>10,081,661</b>	<b>23,850,577</b>	<b>1,751,864</b>	<b>12,623,767</b>	<b>81,815,577</b>
<b>Rreziku i normës së interesit</b>	<b>(8,237,464)</b>	<b>6,824,283</b>	<b>(4,774,041)</b>	<b>7,127,396</b>	<b>(940,174)</b>	<b>-</b>
<b>Rreziku kumulativ i normës së interesit</b>	<b>(8,237,464)</b>	<b>(1,413,181)</b>	<b>(6,187,222)</b>	<b>940,174</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (e) Rreziku financiar ne regjistrin bankar (vazhdim)

*Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit – regjistri bankar (vazhdim)*

31 dhjetor 2012	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Pa interes	Totali
<b>Aktive financiare</b>						
Arka dhe Banka Qendrore	2,561,365	-	-	-	4,897,611	<b>7,458,976</b>
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	7,753,269	-	-	-	211,394	<b>7,964,663</b>
Letra me vlere te tregtueshme	-	1,531,442	633,984	-	9,571	<b>2,174,997</b>
Aktive financiare mbajtur deri në maturim	2,760,738	1,958,521	8,890,285	1,865,966	380,408	<b>15,855,918</b>
Aktive financiare të vlefshme për shitje	-	-	-	8,360,226	570,480	<b>8,930,706</b>
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	10,372,706	14,037,352	1,782,359	7,859,274	1,062,980	<b>35,114,671</b>
Aktive te tjera	-	-	-	-	1,947,384	<b>1,947,384</b>
<b>Totali</b>	<b>23,448,078</b>	<b>17,527,315</b>	<b>10,306,628</b>	<b>18,085,466</b>	<b>9,079,828</b>	<b>79,447,315</b>
<b>Detyrime financiare</b>						
Detyrime ndaj bankave	-	-	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	36,866,711	9,118,268	17,985,012	152,671	657,650	<b>64,780,312</b>
Borxhi i varur	-	2,233,440	-	-	10,302	<b>2,243,742</b>
Detyrime te tjera	-	-	-	-	680,521	<b>680,521</b>
Kapitali	-	-	-	-	11,742,740	<b>11,742,740</b>
<b>Totali</b>	<b>36,866,711</b>	<b>11,351,708</b>	<b>17,985,012</b>	<b>152,671</b>	<b>13,091,213</b>	<b>79,447,315</b>
<b>Rreziku i normës së interesit</b>	<b>(13,418,633)</b>	<b>6,175,607</b>	<b>(6,678,384)</b>	<b>17,932,795</b>	<b>(4,011,385)</b>	<b>-</b>
<b>Rreziku kumulativ i normës së interesit</b>	<b>(13,418,633)</b>	<b>(7,243,026)</b>	<b>(13,921,410)</b>	<b>4,011,385</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Administrimi i rrezikut ndaj normës së interesit kundrejt limiteve të hendeut prej normave të interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmerinë e aktiveve dhe pasiveve financiare të Bankës në skenare standarde dhe jo-standarde për normat e interesit.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (e) Rreziku financiar ne regjistrin bankar (vazhdim)

##### Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit – regjistri bankar (vazhdim)

Kjo analizë presupozon se të gjithë variablat, sidomos kurset e këmbimit, qëndrojnë të pandryshueshme. Nje ndryshim prej 100 pikesh në normat e interesit në ditën e raportimit do të rriste (ulte) fitimin ose humbjen me: 24,180 mijë Lek më 31 dhjetor 2013 (2012: 53,041 mijë Lek).

		2013	2012
	Ndryshimi i normës së interesit	Ndjeshmeria ndaj fitimit ose humbjes	Ndjeshmeria ndaj fitimit ose humbjes
<i>In Lek '000</i>			
<b>Monedha</b>			
EUR	+ / (-) 100b.p	+ / (-) 12,319	+ / (-) 78,698
USD	+ / (-) 100b.p	+ / (-) 4,420	+ / (-) 7,888
LEK	+ / (-) 100b.p	+ / (-) 41,426	+ / (-) 33,832
Të tjera (GBP/CHF)	+ / (-) 100b.p	+ / (-) 507	+ / (-) 286

Normat mesatare të interesit të ponderuar për kategoritë e ndryshme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës deri më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012 janë si me poshte:

	Norma mesatare e ponderuar e interesit (LEK)		Norma mesatare e ponderuar e interesit (USD)		Norma mesatare e ponderuar e interesit (EUR)	
31 dhjetor	2013	2012	2013	2012	2013	2012
<b>Aktive financiare</b>						
Arka dhe Banka Qendrore	2.47%	2.38%	-	-	-	-
Hua institucioneve financiare	3.75%	3.01%	1.59%	0.20%	1.88%	0.03%
Investime ne letra me vlere	5.04%	7.06%	0.08%	-	5.10%	3.16%
Hua dhënë klientëve	11.44%	9.60%	6.20%	6.32%	6.87%	5.84%
<b>Detyrime financiare</b>						
Detyrime ndaj bankave	-	-	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	4.95%	5.26%	1.24%	1.64%	2.77%	3.01%
Hua të tjera	-	-	-	-	5.28%	5.19%

##### Ekspozimi ndaj rrezikut të këmbimit valutor

Kurset e aplikueshme të këmbimit valutor (Lek për monedhë të huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012 ishin si vijon:

	2013	2012
USD	101.86	105.85
EUR	140.20	139.59
GBP	168.39	171.18
CHF	114.41	115.65

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (e) Rreziku financiar ne regjistrin bankar (vazhdim)

##### *Ekspozimi ndaj rrezikut të këmbimit valutor – regjistri bankar (vazhdim)*

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit nëpërmjet transaksioneve në monedhë të huaj. Duke qenë se monedha e raportimit të Bankës është LEK, pasqyrat financiare të Bankës janë të prekura nga ndryshimet në kursin e këmbimit midis LEK-ut dhe monedhave të tjera.

Analiza e pozicionit monetar më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012, sipas monedhave, shprehet si më poshtë:

31 dhjetor 2013	LEK	EUR	USD	Të tjera	Totali
<i>Shumat në mijë Lekë</i>					
<b>Aktivët financiarë</b>					
Arka dhe Banka Qendrore	3,265,282	7,430,776	280,583	15,899	<b>10,992,540</b>
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	472,089	6,675,574	306,613	198,689	<b>7,652,965</b>
Aktive financiare mbajtur deri në maturim	7,655,400	1,505,274	-	-	<b>9,160,674</b>
Aktive financiare të vlefshme për shitje	9,996,303	9,719,083	890,561	-	<b>20,605,947</b>
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	8,420,934	21,499,123	1,940,636	-	<b>31,860,693</b>
<b>Totali</b>	<b>29,810,008</b>	<b>46,829,830</b>	<b>3,418,393</b>	<b>214,588</b>	<b>80,272,819</b>
<b>Detyrime financiare</b>					
Detyrime ndaj bankave	-	117,111	7,270	-	<b>124,381</b>
Detyrime ndaj klientëve	29,287,249	35,427,820	2,506,521	213,424	<b>67,435,014</b>
Borxhi i varur	-	2,253,954	-	-	<b>2,253,954</b>
<b>Totali</b>	<b>29,287,249</b>	<b>37,798,885</b>	<b>2,513,791</b>	<b>213,424</b>	<b>69,813,349</b>
<b>Rreziku i valutës</b>	<b>522,759</b>	<b>9,030,945</b>	<b>904,602</b>	<b>1,164</b>	<b>10,459,470</b>



## ALPHA BANK ALBANIA SH.A

### Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

#### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

##### (e) Rreziku financiar ne regjistrin bankar (vazhdim)

##### *Ekspozimi ndaj rrezikut të këmbimit valutor – regjistri bankar (vazhdim)*

31 dhjetor 2012	LEK	EUR	USD	Të tjera	Totali
<i>Shumat në mijë Lekë</i>					
<b>Aktivët financiarë</b>					
Arka dhe Banka Qendrore	3,343,375	3,859,971	233,137	22,493	<b>7,458,976</b>
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	410,043	6,536,103	859,112	159,405	<b>7,964,663</b>
Aktive financiare mbajtur deri në maturim	11,532,103	4,323,815	-	-	<b>15,855,918</b>
Aktive financiare të vlefshme për shitje	-	8,930,706	-	-	<b>8,930,706</b>
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	7,375,050	25,732,891	2,006,730	-	<b>35,114,671</b>
<b>Totali</b>	<b>22,660,571</b>	<b>49,383,486</b>	<b>3,098,979</b>	<b>181,898</b>	<b>75,324,934</b>
<b>Detyrime financiare</b>					
Detyrime ndaj bankave	-	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	26,768,119	35,804,314	2,028,345	179,534	<b>64,780,312</b>
Borxhi i varur	-	2,243,742	-	-	<b>2,243,742</b>
<b>Totali</b>	<b>26,768,119</b>	<b>38,048,056</b>	<b>2,028,345</b>	<b>179,534</b>	<b>67,024,054</b>
<b>Rreziku i valutës</b>	<b>(4,107,548)</b>	<b>11,335,430</b>	<b>1,070,634</b>	<b>2,364</b>	<b>8,300,880</b>

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (f) Rreziku operacional

Rreziku operacional përcaktohet si risku i ndodhjes së një ngjarje, me apo pa efekt financiar, që vjen prej proceseve të brendshme të dështuara apo të papërshtatshme, sistemeve të teknologjisë së informacionit, njerëzve (qëllimisht ose jo qëllimisht) dhe prej ngjarëve të jashtme. Rreziku operacional përfshin gjithashtu riskun ligjor i cili asociohet me veprime ligjore me të meta, pasiguri në lidhje me përcaktimin e ligjit cka mund të çojë në interpretime të papërshtatshme dhe inefiçenca të mundshme të kuadrit ligjor.

Objektivi i Bankës është të manaxhojë riskun operacional në menyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe demtimin e reputacionit të Bankës me nje kosto efektive dhe duke shmangur procedurat e kontrollit të cilat kërkojnë iniciativa dhe kreativitet. Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve për adresimin e riskut operacional i është caktuar Drejtimit të Lartë në cdo njesi biznesi. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të Bankës për manaxhimin e riskut operacional në fushat e mëposhtme:

- Kërkesat për ndarje të detyrave në menyrë të përshtatshme, përfshirë dhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- Kërkesat për rakordimin dhe monitorimin e transaksioneve
- Përshtatja me kërkesat rregullatore dhe ligjore
- Dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave
- Kërkesat për vlerësimin periodik të risqeve operationale të hasura, dhe mjaftueshmëria e kontrolleve dhe procedurave për përballjen e risqeve të identifikuar.
- Kërkesat për raportimin e humbjeve operationale dhe propozimi i veprimit të menjëhershëm
- Zhvillimi i planeve emergjente
- Trajnimi dhe zhvillimi profesional
- Standardet etike dhe të biznesit
- Zbulimi i riskut, duke përfshirë dhe sigurinë për efikasitetin.

Përputhshmëria me standardet e Bankës mbështetet nëpërmjet rishikimeve periodike të ndermarra nga Kontrolli i Brendshëm.

Monitorimi i rasteve të risqeve operationale, si dhe analiza e kushteve që ndikojnë këto raste, ndihmojnë në procesin e marrjes së vendimeve për hapat që parandalojnë përsëritjen e tyre në maksimum. Brenda kontekstit për rritjen e ndërgjegjësisë ndaj riskut operacional si dhe për përforcimin e mekanizmave që mbledhin ngjarje të rrezikut operacional, Banka ka forcuar rolin e “Koordinatorit të rrezikut Operacional.” Ky rol i është caktuar punonjësve të Departamenteve të Bankës dhe Njësive të Biznesit për të patur komunikimin e nevojshëm dhe për të promovuar veprimet korrigjuese. Për më tepër, Banka ka instaluar një sistem teknologjik informacioni të Grupit të specializuar për Kapjen e Ngjarjeve, i cili është një platformë e përbashkët që operon në të gjitha entitetet e grupit Alpha Bank. Paralelisht me regjistrimin dhe monitorimin e ngjarjeve që sjellin humbje prej riskut operacional, Alpha Bank Albania në mënyrë të vazhdueshme monitoron dhe raporton në bazë mujore treguesit kryesorë të rrezikut operacional që lidhen me bashkëveprimin e klienteve/palët e tjera, proceset, sistemet, ruajtjen e informacionit, etj.

Në përfundim, Komiteti i Bankes për Administrimin e Riskut Operacional ka një rol mbikqyrës ndaj aktiviteteve të lidhura me manaxhimin e riskut operacional dhe do të sigurojë që këto risqe identifikohen dhe manaxhohen sic duhet. Në vitin 2013 filloi projekti ‘Vetë-vlerësimi i rrezikut dhe kontrollit’ (VVRK). VVRK ka për qëllim t’i mundësojë Bankës që të kuptojë më mirë ekspozimin ndaj riskut operacional nga një perspektivë largpamëse, dhe në këtë mënyrë të bëjë të mundur një menaxhim proaktiv të rrezikut. VVRK është një proces dinamik dhe në vazhdim e sipër, në linjë me burime të tjera informative të rrezikut operacional, duke përfshirë treguesit kryesorë të rrezikut dhe ngjarje të humbjes së të dhënave.

Gjithashtu, përveç Komitetit të Rrezikut Operacional, Banka ka vendosur Komitete të niveleve më të ulëta të cilat janë të përfshira në rishikimin dhe procesin vendimmarrës relevant ndaj ngjarjeve që kanë të bëjnë me rrezikun operacional. Këto Komitete veprojnë brenda limiteve sipas ngjarjeve respektive të riskut.

# ALPHA BANK ALBANIA SH.A

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Shumat në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

### 4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### (f) Menaxhimi i kapitalit

##### *Kapitali rregullator dhe norma e mjaftueshmerise se kapitalit*

Per qellime te manaxhimit te kapitalit, Banka është subjekt i rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për mjaftueshmerinë e kapitalit” në përputhje me ligjin “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Ne implementimin e kërkesave aktuale për kapital, Banka Qendrore kërkon nga Bankat e nivelit të dytë që të mbajnë një raport të përcaktuar të kapitalit gjithsej kundrejt aktiveve gjithsej të ponderuara me riskun dhe zërat jashtë bilancit, raport ky që duhet të jetë minimumi 12%. Raporti i kërkuar nga Banka Qendrore më 31 dhjetor 2013 për Bankën ishte 15%, ndërkohë që Banka ka arritur ta tejkalojë raportin e kërkuar duke arritur në 18.99% më 31 dhjetor 2013 (2012: 17.54%).

Raporti i Modifikuar i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është raporti i kapitalit bazë ndaj aktiveve të ponderuar me riskun dhe zërat “jashtë bilancit,” i shprehur në përqindje. Minimumi i mjaftueshmerisë së modifikuar të kapitalit është 6%, ndërkohë që Banka ka arritur ta tejkalojë raportin e kërkuar duke arritur në 12.73% (2012: 12.09%).

Gjate periudhes nuk ka pasur ndryshime materiale në manaxhimin e kapitalit nga ana e bankes dhe Banka ka qene në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në lidhje me kapitalin.

#### (g) Analiza e maturitetit të aktive dhe detyrimeve

Tabelat e mëposhtme paraqesin një analizë të aktiveve dhe detyrimeve të analizuara sipas kohës kur ato pritet të rikupërohen ose shlyhen.

	<b>Brenda 12 muajsh</b>	<b>Pas 12 muajsh</b>	<b>Totali 2013</b>	<b>Brenda 12 muajsh</b>	<b>Pas 12 muajsh</b>	<b>Totali 2012</b>
<b>Aktivët</b>						
